# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5663
E mërkurë, 26 dhjetor 2018
çmimi 0.40 €


## Në meshën e Krishtlindjes bëhet thirrje për paqe dhe dialog FAQE 7




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", RAMUSH TAHIRI FAQE 4-5

# Opozita mund të japë kontribut në dialog edhe pa pjesëmarrje në ekipin negociator



Politologu Ramush Tahiri ka deklaruar se opozita mund të japë kontribut në dialogun me Serbinë edhe duke mos qenë pjesë e ekipit negociator. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se roli i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Lëvizjes Vetëvendosje (LV) ndaj këtij procesi nuk duhet të jetë vetëm kundërshtimi politik. Tahiri ka bërë me dije se këto dy subjekte politike duhet të jenë konstruktive në këtë proces, duke ofruar alternativa. Sipas tij, opozita nuk bën të jetë neutrale ndaj dialogut dhe të thotë se dialogu me Serbinë është punë vetëm e Qeverisë

## AKTUALE

### POZITA GJEOSTRATEGJIKE E KUFIRIT TË KOSOVËS ME SERBINË F. 10



Shkruan: Prof. ass. dr. Sabri KIÇMARI

### ORGANIZIMI I DEMONSTRATAVE NË TETOVË MË 22-23 DHJETOR 1968 F. 16



Prof. dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA

### MYFTIU TËRNAVA URON IPESHKËV DODË GJERGJIN PËR KRISHTLINDJE F. 2

## Pavarësisht prej përpjekjeve, spektri politik s'ka unitet për dialogun FAQE 3



Tryezës së thirrur nga Veseli nuk i bashkohen LDK-ja dhe Vetëvendosja

Sot (e mërkurë) në orën 10:00 do të mbahet takimi i përbashkët në mes të liderëve shtetërorë, udhëheqësve të ekipit negociator dhe përfaqësuesve të partive politike ku do të diskutohet për temat e dialogut me Serbinë. Pavarësisht prej ftesës, dy partitë opozitare, LDK-ja dhe Vetëvendosja, nuk do të marrin pjesë në tryezën e thirrur nga kryeparlamentari Kadri Veseli. Megjithatë, Veseli ka thënë se në këto çaste të rëndësishme Kuvendi i Kosovës do të jetë vend i unitetit



## Haradinaj: Me vendosjen e taksës po mbrojmë sigurinë kombëtare FAQE 6

## EKONOMI



### SHQIPËRIA IA MERR PRIMATIN SERBISË PËR T'I SHITUR MALLRA KOSOVËS F. 9

### KEDS-I REAGON PAS DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA MOTI I LIG F. 9

## SPORT

### ZABERXHA REFUZON LLAPIN DHE VËLLAZNIMIN F. 16




RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755 Fax: +389 44 487 200 Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051 044/367-061 028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Gjuha shqipe, lëndë zgjedhore në Turqi



**Ankara, 25 dhjetor** - Gjuha shqipe si lëndë zgjedhore në shkollat tetëvjeçare në Turqi, përkrah kurseve intensive të pavarura të shqipes, është konsideruar si një arritje e rëndësishme nga ambasadori i Shqipërisë në Turqi, Genti Gazheli.
Në mesazhin drejtuar shqiptarëve me rastin e festave të fundvitit, Gazheli ka evidentuar të gjitha sfidat dhe arritjet gjatë vitit 2018. "2018-a po mbledh rrezet e fundit dhe kjo ambasadë mendon se i ka përmbushur më së miri sfidat që u shfaqën. Sfidat tona në të shumtën e rasteve ishin dhe janë kurorëzim suksesesh. Viti që po lëmë, për nga ana e realizimit të objektivave, mund të thuhet se ka shumë pika për t'u vënë në pah", ka thënë Gazheli.
Numri i individëve apo i bizneseve, që duan të vijnë në Turqi apo të shkojnë në Shqipëri, sipas ambasadorit, është gjithnjë në rritje. "Natyrisht, marrëdhëniet strategjike me Turqinë janë të përsosura dhe ne vazhdojmë të punojmë për cilësi të lartë në këtë aspekt. Gjithsesi, krahas këtyre marrëdhënieve të mira politike, fusha ekonomike mbetet përparësi, ku duhet punuar më tepër për këtë qëllim. Në këtë pikë ndërhyrja e Turqisë është thelbësore", ka thënë Gazheli. Sa i përket gjeopolitikës, Gazheli ka vlerësuar se Turqia është një ndër partnerët besnik të Shqipërisë dhe të çështjes shqiptare kudo në botë, të cilën e ka vërtetuar me mbështetjen e fundit të kandidaturave tona në OSBE, në Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal etj.

# Ligji për shqipen në Maqedoni hyn në fuqi së bashku me Marrëveshjen për emrin

Kryeparlamentari Talat Xhaferi, duke komentuar refuzimin e presidentit Gjorge Ivanov, për ta dekretuar Ligjin për gjuhën, por edhe fazën e parë të Marrëveshjes me Greqinë, ka thënë se askush nuk do të mund ta ndalojë fuqizimin e këtyre akteve ligjore


Armend Nimani (AFP)

**Shkup, 25 dhjetor** - Ligji për përdorimin e gjuhëve, që avancon përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe, do të fuqizohet së bashku me marrëveshjen me Greqinë për zgjidhjen e kontestit të emrit. Kjo marrëveshje, sipas kryetarit të Kuvendit, Talat Xhaferi, por edhe zyrtarëve të Qeverisë, pritet të miratohet në seancën e caktuar për 9 janar, ndërsa më pas, së bashku me Ligjin e gjuhëve, do të dërgohet për botim në "Gazetën Zyrtare".
Kryeparlamentari Talat Xhaferi, i pyetur ta komentojë refuzimin e presidentit Gjorge Ivanov për ta dekretuar Ligjin për gjuhën, por edhe fazën e parë të Marrëveshjes me Greqinë, ka thënë se askush nuk do të mund ta ndalojë fuqizimin e këtyre akteve ligjore.
"Nuk kam nevojë të merrem vesh me dikë kur janë në pyetje kompetencat kushtetuese të institucioneve. Presidenti Ivanov ishte i obliguar që këtë ta bënte, por nuk e bëri, kështu që konsideroj se është një çështje e absorbuar. Mendoj se askush nuk ka të drejtë ta pengojë vullnetin e deputetëve dhe kjo edhe do të ndodhë", ka deklaruar Xhaferi.
Kryeparlamentari Xhaferi është shprehur i bindur se amendamentet kushtetuese do të votohen në afatin e paraparë, ndoshta edhe më herët se 15 janari, pasi nuk pret debat nga deputetët, edhe për faktin se VMRO-ja opozitare ka bërë me dije se nuk do të marrë pjesë në seancë, duke e quajtur farsë gjithë debatin për shkak të refuzimit të vërejtjeve të saj që kanë të bëjnë me kundërshtimin e Marrëveshjes për emrin, të cilën e vlerëson si "kapitulluese për vendin". Por, nga opozita shqiptare, e cila edhe më parë ka pasur vërejtje për statusin e gjuhës shqipe, thonë se tashmë kanë hartuar amendamente me qëllim avancimin e gjuhës shqipe, përkatësisht barazinë e saj me gjuhën maqedonase. "Në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjuhë tjetër zyrtare, përveç gjuhës maqedonase, është edhe gjuha shqipe dhe shkrimi i saj latin. Pra, kërkojmë një ndryshim vetëm të paragrafit 2 të amendamentit 5 të Kushtetutës", ka deklaruar Fadil Zendeli, deputet i Lëvizjes Besa, parti kjo e cila vepron në dy pjesë, njëra në Qeveri, e tjetra në opozitë.
Ligji për përdorimin e gjuhëve është miratuar më 14 mars, ndërsa tri ditë më vonë presidenti Ivanov kishte njoftuar se refuzon dekretimin e tij. Ligji sërish është miratuar më 19 mars, por presidenti sërish ka refuzuar ta nënshkruajë atë, edhe pse Kushtetuta e detyronte ta dekretojë pas kalimit të dytë në Kuvend.
Presidenti Ivanov Ligjin për përdorimin e gjuhëve e ka vlerësuar "antikushtetues, antishtetëror dhe nxitës të tensioneve ndëretnike". Ligji ndërkohë mbeti anash për shkak të rrethanave politike, arritjes së Marrëveshjes me Greqinë për emrin në qershor, referendumit si dhe procedurave tjera për zbatimin e saj. Përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe është formuluar si "gjuhë të cilën e flasin mbi 20 për qind nga numri i përgjithshëm i popullatës në Maqedoni". Ligji avancon përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe, si në të folur ashtu edhe në të shkruar, në të gjitha institucionet e nivel lokal dhe qendror.

## Vuçiqi: Situata e serbëve në Kosovë po përkeqësohet



**Beograd, 25 dhjetor** - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, tha se situata e serbëve në Kosovë po përkeqësohet, sepse Prishtina, sipas të gjitha gjasave, deri në vitin e ri nuk do ta heqë tarifën për mallrat serbe. Por, Vuçiqi tha se Serbia në të gjitha mënyrat do ta ndihmojë popullin e saj në Kosovë. Ai tha se gjatë vitit të ardhshëm do ta rrisë ndihmën për serbët e Kosovës, në mënyrë që të ketë më shumë fëmijë serbë.
Duke folur për letrën që e ka dërguar presidenti i ShBA-së, Donald Trump, Vuçiqi tha se përmes saj, presidenti Trump, ka shfaqur dëshirën që problemi në mes të Prishtinës dhe Beogradit të zgjidhet. Sipas tij, presidenti amerikan për herë të parë ka përmendur se po shkohet drejt një zgjidhje kompromisi. Vuçiqi tha se e vetmja pjesë në letër për të cilën ai mendon se nuk është e vërtetë, është pjesa ku thuhet se Prishtina dhe Beogradi janë afër një marrëveshje. "Ato nuk janë afër marrëveshjes", tha Vuçiqi.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Pavarësisht prej përpjekjeve, spektri politik s'ka unitet për dialogun

## - Tryezës së thirrur nga Veseli nuk i bashkohen LDK-ja dhe Vetëvendosja



**Sot (e mërkurë) në orën 10:00 do të mbahet takimi i përbashkët në mes të liderëve shtetërorë, udhëheqësve të ekipit negociator dhe përfaqësuesve të partive politike ku do të diskutohet për temat e dialogut me Serbinë. Pavarësisht prej ftesës, dy partitë opozitare, LDK-ja dhe Vetëvendosja, nuk do të marrin pjesë në tryezën e thirrur nga kryeparlamentari Kadri Veseli. Megjithatë, Veseli ka thënë se në këto çaste të rëndësishme Kuvendi i Kosovës do të jetë vend i unitetit**

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 25 DHJETOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe lideri i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, sot (e mërkurë) do të jetë nikoqir i takimit të përbashkët në mes të liderëve shtetërorë, ekipit negociator dhe të liderëve të partive politike, ku do të diskutohet për vazhdimin e dialogut me Serbinë. Veseli ka bërë me dije se në këtë takim do të trajtohen temat e dialogut të cilat janë të domosdoshme për arritjen e marrëveshjes finale, që Kosovës ia siguron njohjen nga Serbia, ulësen në OKB si dhe anëtarësimin në NATO e BE. Ai ka thënë se në këto momente të rëndësishme, kur Kosova përgatitet për fazën finale të dialogut me Serbinë, Kuvendi i Republikës së Kosovës do të jetë vend i unitetit.

Veseli ka theksuar se vendimmarrja për ushtrinë është dëshmi se spektri politik i Kosovës ka gjithë forcën e duhur për t'i dhënë shans konsensusit të brendshëm për çështjet e interesit nacional por, sipas tij, mjafton të frenohen egot personale. "Në këtë frymë u ndërmor iniciativa parlamentare për rezolutën e propozuar nga PSD-ja përmes së cilës u krijua delegacioni shtetëror, i cili do ta përfaqësojë Kosovën në dialogun me Serbinë. PSD-ja, si parti opozitare, arriti në fund t'i vendosë interesat nacionale mbi dëshirat e ngushta partiake", ka thënë Veseli në një shkrim autorial.

Ai ka folur edhe për mospjesëmarrjen e LDK-së dhe të Vetëvendosjes në takimin e së mërkurës, duke thënë se këto dy parti në kundërpërgjigje të ftesës së tij kanë thirrur një seancë të jashtëzakonshme. "Kam besuar se edhe dy partitë e tjera opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Lëvizja Vetëvendosje, do të ecin në të njëjtin drejtim, duke menduar se janë pjekur të gjitha kushtet që ta bëjmë atë për të cilën jemi zgjedhur: veprimin e përbashkët në të mirë të vendit. Nisur nga kjo sot (e mërkurë) kam ftuar në Kuvendin e Kosovës, në një takim të përbashkët, presidentin, kryeministrin, ekipin negociator, si dhe përfaqësuesit e grupeve parlamentare nga partitë opozitare, ende të papërfaqësuara në ekipin negociator, LDK dhe LV, që të koordinohemi për dialogun. Natyrisht për asnjë motiv tjetër, veç motivit për të ndihmuar kohezionin e brendshëm politik në raport me çështjet e dialogut me Serbinë dhe duke zgjedhur institucionin më të duhur për këtë qëllim, Kuvendin e Kosovës. Në Kuvendin e Kosovës, aty ku përfaqësohen të gjithë, sepse LDK-ja dhe LV-ja askund nuk po arrijnë të marrin vendime. Mbeta pak i zhgënjyer, por jo i habitur, kur mora vesh se LDK-ja dhe Vetëvendosja, si duket në kundërpërgjigje të ftesës sime, kanë thirrur një seancë të jashtëzakonshme. Në këtë seancë, siç thuhet, do të debatohet për draftmarrëveshjen e propozuar nga Qeveria e Kosovës për dialogun me Serbinë", ka deklaruar Veseli duke shtuar se LDK-ja nuk po arrin të vetëçlirohet nga politika e inatit dhe me këtë është duke i bërë dëm vendit dhe vetes. "Iniciativa aktuale e saj dhe e LV-së për seancë të jashtëzakonshme është e drejtë e tyre të cilën mund ta realizojnë sa herë që plotësojnë kushtet për thirrjen e saj. Por çfarë do të arrihet me këtë seancë? Nëse duan ta vazhdojnë bojkotin dhe papërgjegjësinë, gjithsesi do ta arrijnë këtë! Nuk e di nëse opozita, veçanërisht LDK-ja, sa është duke e kuptuar çfarë dëmi po i shkakton vendit!", është shprehur Veseli.

Ai ka theksuar se delegacioni shtetëror për dialogun me Serbinë nuk është duke ecur në rrugë pa krye, aq më pak të motivuar nga ndonjë interes që bie në kundërshtim me interesin shtetëror të Kosovës. "Ne veprojmë mbi një platformë, e cila u qëndron besnikërisht parimeve kushtetuese të vendit dhe kemi qëllime të qarta, të cilat duam t'i arrijmë me anë të dialogut. Ne shkojmë në dialog me Serbinë për ta fuqizuar Kosovën. Nuk do të ketë rezultat tjetër në finish të tij. Sovraniteti dhe integriteti i shtetit të Kosovës janë dhe do të mbesin të paprekshëm, para dhe pas dialogut", ka potencuar Veseli.

Bashkëdrejtuesi i delegacionit shtetëror të Kosovës në dialog me Serbinë, Fatmir Limaj, ka thënë të hënën se Kosova do ta ketë një zë unik dhe një platformë të përbashkët në këtë proces. "Po shkojmë drejt unifikimit të fuqizimit dhe një adrese të fuqishme, e cila do të jetë e gatshme për të negociuar një marrëveshje finale të mundshme me Serbinë", ka shtuar Limaj pas takimit të dytë të këtij delegacioni. Sipas Limajt, presidenti i vendit, kryeministri dhe kryeparlamentari kanë ofruar mbështetjen e plotë për delegacionin. "Presidenti dhe kryeministri do ta furnizojnë delegacionin shtetëror me të gjithë ato tema që janë diskutuar deri më tani. Në ditët në vazhdim do ta marrim gjithë dokumentacionin dhe temat që janë trajtuar dhe dalëngadalë delegacioni do t'i trajtojë", është shprehur Limaj. Ai ka thënë se në dhjetëditëshin e parë të muajit janar delegacioni do të udhëtojë për Bruksel me ftesë të BE-së.

## Mustafa: Nuk i bashkohemi ekipit të dialogut, do t'i mbrojmë interesat e vendit si opozitë

Lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka ripërsëritur se kjo parti nuk do t'i bashkëngjitet ekipit të dialogut me Serbinë. Ai ka thënë se LDK-ja do t'i mbrojë interesat e vendit si opozitë. "Pikëpamjet e mia për unitet karshi Serbisë, të shprehura në postimin paraprak, nuk përfaqësojnë pikëpamje se do t'i bashkohemi apo bashkëngjitemi asnjë ekipi në dialog, por se do t'i mbrojmë interesat e vendit si opozitë dhe si parti e cila përfaqëson një trashëgimi të veçantë historike. Qëndrimet e LDK-së janë të qarta", ka shkruar Mustafa në llogarinë e vet në "Facebook". Por, Mustafa në një status paraprak ka shkruar për nevojën e veprimeve të përbashkëta në mbrojtje të asaj që është arritur deri më tani. "Edhe tani, kur po ballafaqohemi me tendencat e Serbisë për të shkallmuar një pjesë të territorit të Kosovës dhe për ta bërë jofunksional shtetin tonë të ri, kemi nevojë të veprojmë bashkërisht për ta mbrojtur atë çfarë të gjithë e kemi ndërtuar", ka shkruar Mustafa, duke shtuar se marrëveshja me Serbinë nuk mund të arrihet pa dy krahët, atë të trashëgimisë së rezistencës së Ibrahim Rugovës dhe atë të dalë nga UÇK-ja. "Në këto procese nuk mund të përjashtohet askush, sepse nuk ka parti dhe njeri që nuk e do Kosovën dhe shtetin e Kosovës, por çdokush e do sipas mënyrës së vet dhe me kutin e vet. Në kohën kur kemi institucione kushtetuese nuk na lejohet të improvizojmë, sepse zgjidhja mund të jetë ajo që është e pranueshme për shumicën që e përcakton Kushtetuta jonë", është shprehur Mustafa.

Flet për "Epokën e re", Ramush Tahiri

# Opozita mund të japë kontribut në dialog



Politologu Ramush Tahiri ka deklaruar se opozita mund të japë kontribut në dialogun me Serbinë edhe duke mos qenë pjesë e ekipit negociator. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se roli i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Lëvizjes Vetëvendosje (LV) ndaj këtij procesi nuk duhet të jetë vetëm kundërshtimi politik. Tahiri ka bërë me dije se këto dy subjekte politike duhet të jenë konstruktive në këtë proces, duke ofruar alternativat e tyre. Sipas tij, opozita nuk bën të jetë neutrale ndaj dialogut dhe të thotë se dialogu me Serbinë është punë vetëm e Qeverisë

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 25 DHJETOR - Politologu Ramush Tahiri ka bërë me dije se dy subjektet politike më të mëdha opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lëvizja Vetëvendosje (LV), mund ta japin kontributin e tyre në fazën finale të dialogut me Serbinë edhe duke mos qenë pjesë e ekipit negociator. Ai ka deklaruar se ky rol i tyre nuk duhet të keqkuptohet nga opinioni.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Tahiri ka thënë se këto dy subjekte politike duhet të jenë konstruktive në këtë proces me kritikat e tyre. "Opozita duhet ta luajë rolin opozitar dhe të jetë konstruktive në kritikat e saj në raport me këtë proces. Pra, kundërshtimi i opozitës ndaj ndonjë marrëveshje të mundshme të mos jetë vetëm kundërshtim politik, por të jetë kundërshtim i bazuar në fakte, që ajo marrëveshje të ndryshohet në pjesën që kon-

# edhe pa pjesëmarrje në ekipin negociator



siderohet se nuk është e favorshme për Kosovën", ka thënë Tahiri. Ai ka vlerësuar se opozita nuk bën të jetë neutrale ndaj këtij procesi dhe të thotë se dialogu me Serbinë është punë vetëm e Qeverisë. "Përgjegjësi e këtyre dy partive do të jetë edhe nëse qëndrojnë si opozitë dhe kritikojnë këtë proces. Mendoj se kontributi i opozitës do të jetë edhe më i madh duke qëndruar në rolin opozitar, sepse duke kritikuar sjell zgjidhje që janë më të mira për Kosovën në këtë proces. Në momentin që ajo e përkrah dialogun, do të thotë se dialogu vlen", është shprehur Tahiri. Në këtë intervistë ai ka folur edhe për ekipin negociator i cili është miratuar në Kuvend. Sipas Tahirit, ky ekip nuk mund ta kufizojë rolin prijës të presidenti Thaçi në këtë proces. "Ky ekip i votuar në Kuvend, ani pse në opinion pati përpjekje që të shihet si mekanizëm që do ta kufizojë rolin e presidentit, nuk mund ta kundërshtojë presidentin sepse, siç po shihet edhe nga projektligji, nuk mund t'i merren kompetencat presidentit, ngaqë ato janë kompetenca kushtetuese dhe në asnjë mënyrë nuk mund të zvogëlohet roli i presidentit", ka thënë Tahiri.

**"Epoka e re":** *Z. Tahiri, ndonëse nuk është arritur konsensusi i kërkuar kombëtar, Kuvendi ka arritur ta miratojë një rezolutë për dialogun me Serbinë. Si e keni parë këtë vendim të Kuvendit?*

**Tahiri:** Kjo si nismë është e mirë dhe si gatishmëri është e pranueshme, por si rezultat ashtu-ashtu. Kjo përpjekje nuk i ka marrë dy të tretat e votave në Kuvend, por më pak se 60 vota. Ky është një konsensus i atyre që dëshirojnë të jenë pjesëmarrës, në këtë rast prej koalicionit qeverisës dhe PSD-së. Megjithatë, është bërë një rezolutë dhe tash po bëhet një ligj dhe po i jepet një dimension legal këtij procesi. Jo pse nuk e ka pasur deri më tani këtë dimension ky proces, por që ky koalicion qeverisës po dëshiron të jetë më i sigurt në këtë drejtim. Gjithashtu, Qeveria po dëshiron ta autorizojë një ekip prej disa njerëzve që synojnë ta shprehin pluralitetin e partive politike dhe pak a shumë ta shpërndajnë përgjegjësinë si dhe ta rrisin transparencën.

**"Epoka e re":** *Kjo nismë është arritur si rezultat i veprimit të një partie opozitare, PSD-së?*

**Tahiri:** Partia Socialdemokrate, e cila është shkëputur nga Lëvizja Vetëvendosje, po dëshiron ta bëjë një distancim nga burimi, pra nga Vetëvendosja. Ajo po dëshiron ta gjejë një identitet të vetin ndryshe prej Lëvizjes Vetëvendosje dhe ndryshe prej partive të tjera. Tani PSD-ja ka dalë me një dokument me të cilin kërkon të krijojë një opinion, një strukturë të votuesve. Si PSD nuk ka arritur të shtrihet në të gjithë Kosovën dhe duket se në disa çaste po ka edhe ngecje karshi Vetëvendosjes, e cila po konsolidohet prej asaj thyerjes së madhe me grupin që doli prej saj. PSD-ja ka llogaritur që deri në zgjedhjet e ardhshme të forcohet, duke u faktorizuar përmes kësaj iniciative dhe që kryeministri Haradinaj e ka miratuar.

**"Epoka e re":** *Pse mendoni se Qeveria e pranoi këtë propozim të saj?*

**Tahiri:** Arsyeja pse kryeministri Haradinaj e ka miratuar këtë është se tash me 12 deputetët e PSD-së forcohet, duke e siguruar shumicën e nevojshme për ta vazhduar qeverisjen. E pamë se ata e votuan buxhetin dhe gjithashtu kryeministri nuk ia ka nevojën Listës Serbe dhe AKR-së, e cila me dy deputetë i ka marrë një hise të madhe Qeverisë. Pra, ky rol i PSD-së, përmes të cilit po synohet forcimi i kësaj partie dhe krijimi i një imazh të mirë, njëkohësit po i sjell të mira edhe koalicionit qeverisës. Në këtë mënyrë po i forcohet pozita e kryeministrit, Ramush Haradinajt, ngaqë po sigurohet se nuk mund të rrëzohet me anë të mocionit të mosbesimit deri në përfundim të mandatit të vet. Rezoluta për dialogun që ka kaluar në Kuvend, e cila parasheh hartimin e platformës dhe ligjin për negociata, është përpjekje për konsensus për dy të tretat e votave. Marrëveshje e cila mund të arrihet në këtë proces duhet të miratohet në Kuvend me dy të tretat e votave.

**"Epoka e re":** *Ekipi negociator për bisedime me Serbinë është kritikuar nga opozita për moslegjitimitet të plotë?*

**Tahiri:** Ky ekip i votuar në Kuvend, ani pse në opinion pati përpjekje që të shihet si mekanizëm që do ta kufizojë rolin e presidentit, nuk mund ta kundërshtojë presidentin sepse, siç po shihet edhe nga projektligji, nuk mund t'i merren kompetencat presidentit, ngaqë ato janë kompetenca kushtetuese dhe në asnjë mënyrë nuk mund të zvogëlohet roli i presidentit. Nënshkrues i marrëveshjes do të jetë presidenti, ndërsa ekipi negociues do ta ndihmojë presidentin në këtë proces. Nuk është ajo çfarë ka thënë në konferencën për media Shpend Ahmeti, se këta do të kërkojnë raport nga presidenti. Këta do të bashkëbisedojnë me presidentin dhe ai do të kërkojë prej tyre raport. Presidenti është i veshur me pushtet nga Kushtetuta dhe ligji që t'i udhëheqë bisedimet dhe që ta përfaqësojë Kosovën brenda dhe jashtë vendit. Në një farë forme ky ekip do ta zëvendësojë atë ekipin që e ka udhëhequr Avni Arifi deri më tani. Pra, do të jetë ekip teknik që do t'i udhëheqë bisedimet teknike dhe do të marrë pjesë në bisedimet politike kur të shkojë Hashim Thaçi në Bruksel. Simpatike është ideja që udhëheqës i këtij ekipi të jetë një përfaqësues i pozitës dhe një i opozitës, si dhe brenda këtij ekipi të jetë një përfaqësues nga shoqëria civile.

**"Epoka e re":** *Cili është qëndrimi juaj ndaj pozicionit të dy partive më të mëdha opozitare karshi këtij procesi?*

**Tahiri:** Në këto procese, në aspektin ligjor, LDK-ja si parti me përvojë mendoj se ka të drejtë. Ajo po thotë lërmëni të rrijë në opozitë sepse kur isha në pozitë nuk ju kam pëlqyer. Është fakt që LDK-ja po dëshiron të qëndrojë në opozitë duke refuzuar të jetë pjesë e këtij ekipi negociator. LDK-ja mendon se duke qenë në opozitë mund të ketë vlerësim më kritik ndaj bisedimeve dhe mund ta kushtëzojë votën e saj për ose kundër, varësisht prej rezultateve të këtyre bisedimeve. Kurse Vetëvendosja parimisht e ka kundërshtimin por, për mendimin tim, nuk e ka një vizion të qartë se çka duhet të bëjë me bisedimet. Këto bisedime kanë ecur më shumë. Lëvizja Vetëvendosje ka të drejtë kur thotë se Kosova dhe Serbia duhet të bisedojnë si dy shtete të pavarura, mirëpo gjendja nuk është kështu.

**"Epoka e re":** *Letra e presidentit amerikan drejtuar presidentit Thaçi dhe deklarimet e zyrtarëve më të lartë të BE-së flasin për një përgjegjësi edhe të opozitës në këtë proces, meqenëse po bëhet fjalë për një marrëveshje historike me Serbinë. Si duhet të veprojnë këto dy subjekte politike në raport me këtë proces?*

**Tahiri:** Përgjegjësia e opozitës ndaj këtij procesi nuk bën për t'u kuptuar në opinion keq, vetëm si pjesëmarrje në proces të dialogut apo duke qenë anëtare të ekipit negociator. Përgjegjësia e këtyre dy partive do të jetë në nivel edhe nëse qëndrojnë si opozitë dhe kritikojnë këtë proces. Mendoj se kontributi i opozitës do të jetë edhe më i madh duke qëndruar në rolin opozitar, sepse duke kritikuar sjell zgjidhje që janë më të mira për Kosovën në këtë proces. Në momentin që ajo e përkrah dialogun do të thotë se dialogu vlen dhe nuk e bën këtë vetëm për shkak të servilizmit apo qëndrimeve të ndërkombëtarëve. Opozita nuk duhet të rrijë neutrale dhe të thotë se dialogu është punë e Qeverisë. Opozita duhet ta luajë rolin opozitar dhe të jetë konstruktive në kritikat e saj në raport me këtë proces. Pra, kundërshtimi i opozitës ndaj ndonjë marrëveshje të mundshme të mos jetë vetëm kundërshtim politik, por të jetë kundërshtim i bazuar në fakte, që ajo marrëveshje të ndryshohet në pjesën që konsiderohet se nuk është e favorshme për Kosovën. Pra, opozita duhet ta luajë rolin konstruktiv opozitar dhe të japë kontribut me propozime konkrete për bisedimet.

# Haradinaj: Me vendosjen e taksës po mbrojmë sigurinë kombëtare

Kryeministri Ramush Haradinaj ka bërë me dije të martën se, përderisa Serbia vazhdon të veprojë kundër Kosovës, taksa prej 100 përqindësh ndaj produkteve serbe nuk do të hiqet



EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë të martën se tarifa e vendosur ndaj mallrave serbe është e drejtë e Kosovës dhe se përmes saj "po e mbrojmë sigurinë kombëtare". "Sa i përket taksës, është e drejtë e jona dhe e mbrojmë sigurinë tonë. Kryeministrja e Serbisë vazhdon t'u dërgojë letra shteteve, i ka dërguar edhe Shqipërisë, për ta tërhequr njohjen e Kosovës. Pra, përderisa Serbia ka këtë qasje, atëherë kuptohet shumë mirë se çfarë kemi vepruar ne", ka thënë Haradinaj. Ai këto komente i ka bërë gjatë një aktiviteti në mbështetje të fëmijëve me sëmundjen e autizmit.

Kryeministri Haradinaj ka përsëritur disa herë se nuk do ta tërheqë tarifën ndaj mallrave serbe dhe të Bosnjës derisa të ndodhë njohja e Kosovës. Për taksën ka reaguar të martën edhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli. Ai ka thënë se është në mbështetje të vendimit të Qeverisë për taksën derisa Serbia vazhdon ta urrejë Kosovën dhe popullin e saj.

Zëvendësministri në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Mevludin Krasniqi, ka thënë se taksa prej 100-përqindësh ka dhënë rezultatet e veta. "Këtë e tregojnë më së miri edhe të dhënat nga Dogana e Kosovës, por natyrisht kemi edhe shtim të konsumit të produkteve të prodhuara në Kosovë", është shprehur Krasniqi.

Ish-ministri i Financave, Haki Shatri, ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se taksa mbrojtëse e vendosur nga Qeveria e Kosovës ndaj mallrave serbe dhe të Bosnjë Hercegovinës ka ardhur si masë ndaj sjelljeve të këtyre dy vendeve karshi shtetit të Kosovës. "Kjo masë nuk është e afatizuar. Masa do të jetë në fuqi deri në ndryshimin e sjelljes së këtyre dy vendeve ndaj Kosovës. Deri më tani Serbia e ka shfrytëzuar tregun e Kosovës pa asnjë pengesë, në të njëjtën kohë ka penguar plasmanin e mallrave të Kosovës në Serbi. Pra, Serbia ka vënë një varg masash dhe pengesash formale dhe administrative me të cilat ka penguar qarkullimin e mallrave të Kosovës jo vetëm drejt Serbisë, por edhe drejt vendeve të tjera që kanë kaluar nëpër Serbi", ka thënë Shatri, i cili është edhe këshilltar për ekonomi i kryeministrit Haradinaj.

Ai ka thënë se Serbia ka shkelur vazhdimisht rregullat e CEFTA-s dhe marrëveshjet e Brukselit. "Askush nga faktori ndërkombëtar që ka ndërmjetësuar bisedimet nuk ka reaguar. BE-ja nuk ka reaguar as për mosfunksionalizimin e pikave kufitare nga ana e Serbisë, për të cilat BE-ja ka investuar. Serbia në marrëdhëniet ekonomike me Kosovën ka bërë pengesa në transport, në energji dhe në konkurrueshmëri. Po ashtu, nuk respektohen rregullat e origjinës së mallit dhe bashkëpunimit doganor, përdorin vula doganore paralele, nuk bashkëpunojnë për menaxhimin e integruar të kufijve, nuk i njohin certifikatat sanitare dhe fitosanitare të Kosovës, por i detyrojnë kompanitë e Kosovës të nxjerrin certifikata në Serbi dhe kjo kërkon kohë dhe shpenzime shtesë të cilat janë të papërballueshme për bizneset tona. Pengojnë në funksionalizimin e linjës së tensionit të lartë Kosovë - Shqipëri, nuk mundësojnë pagesën e energjisë të shpenzuar në veri, lobojnë kundër anëtarësimit të Kosovës në institucionet ndërkombëtare, subvencionojnë mallrat serbe që eksportohen në Kosovë etj. Pra, masa mbrojtëse e Kosovës do të hiqet në atë moment kur Serbia e njeh Kosovën shtet sovran dhe të pavarur, që nënkupton edhe ndërprerjen e veprimeve destruktive ndaj Kosovës", ka deklaruar Shatri.

Heqjen e tarifës e kanë kërkuar zyrtarë të lartë të Bashkimit Evropian si dhe Serbia e cila ka vendosur të mos vazhdojë dialogun me Kosovën derisa të shfuqizohet kjo masë nga ana e autoriteteve në Prishtinë.

# Hasani: ShBA-ja s'do ta imponojë zgjidhjen ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

PRISHTINË, 25 DHJETOR - Letrat e presidentit të ShBA-së, Donald Trump, për presidentët e Kosovës dhe të Serbisë, janë inkurajim për arritjen e një marrëveshjeje në mes të palëve, por jo që ajo domosdo të jetë copëtimi i Kosovës ose ngjashëm. Kështu ka thënë në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", profesori i të Drejtës dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Enver Hasani, ish-kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Ai nuk e përjashton mundësinë që ideja për ndryshim të kufijve të jetë në tavolinën e bisedimeve por, sipas tij, është gabim që të rihapet çështja e kufijve, përgjithësisht në Ballkan. "T'ju them një fakt, edhe çështja e integrimeve evropiane në vitin që vjen, por edhe çështja e përfshirjes amerikane këtu në rajon, jo vetëm në Kosovë dhe në Lindjen e Mesme është e një natyre tjetër prej asaj që kemi parë deri më sot. Ajo natyrë është që aktorëve lokalë u lihen punët kryesore që t'i kryejnë, ndërkohë që Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian pritet të luajnë një rol lehtësues, ndërmjetësues dhe garantues të asaj që arrihet në mes të palëve me vullnet dhe jo sikur dikur që është imponuar një marrëveshje - jo vetëm e Dejtonit, por edhe e Rambujesë dhe të gjitha ato që kanë qenë në rajon. Do të ishte paradoksale që të ndodhë, që të pritet të ketë ndonjë formë presioni, në kuptim të imponimit të një zgjedhjeje të caktuar, sepse do të ishte një investim i madh, një çmim i madh për çka unë dyshoj. Tekefundit, Kosova dhe kjo pjesë e Ballkanit, me zgjidhjen e problemit të Maqedonisë (çështja e emrit) dhe rrugës së saj drejt NATO-s, Rusisë nuk i ka ngelur vend për t'i shqetësuar interesat amerikane dhe interesat e tjera perëndimore në këtë pjesë të botës", ka thënë Hasani.



# Në meshën e Krishtlindjes bëhet thirrje për paqe dhe dialog

"Dialogu është parakusht i paqes, i pajtimit dhe të së mirës së përbashkët", ka thënë ipeshkvi i Kosovës, Dodë Gjergji, në kremten e Krishtlindjes, ku mesha kryesore e shënimit të kësaj feste u mbajt në katedralen "Nënë Tereza" në Prishtinë, e në të cilën morën pjesë qytetarë të shumtë dhe përfaqësues të institucioneve të vendit



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 DHJETOR - Mesazhe paqeje dhe mirëkuptimi u dhanë në kremten e Krishtlindjes, ku mesha kryesore e shënimit të kësaj feste u mbajt në katedralen "Nënë Tereza" në Prishtinë. Shumë qytetarë kanë marrë pjesë në meshën kryesore. Në



mesin e tyre kishte edhe përfaqësues të ndryshëm diplomatikë duke përfshirë ambasadorin amerikan në Kosovë, Philip Kosnett. Mesha u udhëhoq nga ipeshkvi i Kosovës, Imzot Dodë Gjergji, i cili u lut për më shumë mirëkuptim, paqe dhe dashuri mes njerëzve.

Ipeshkvi i Kosovës, Dodë Gjergji, bëri thirrje për më shumë dialog mes njerëzve. "Dialogu është parakusht i paqes, i pajtimit dhe të së mirës së përbashkët. Buron nga vullneti i mirë dhe dëshira për të ardhme më të mirë të të gjithëve, këndej askush nuk duhet të ndihet i lodhur nga dialogu dhe askush nuk duhet të keqpërdorë apo ta mohojë nevojën për të. Dëshiroj që këtë natë të shenjtë ta ftoj popullin tim shqiptar, kudo që jeton të jetë, i vetëdijshëm se udhëtimi shekullor drejt udhëtimit në familjen e popujve të qytetëruar ka qenë tejet i vështirë. Kjo që gëzojmë sot, por edhe përbashkimi ynë në këtë kishë, duhet të kuptohet se është një sakrificë e gjeneratave të shumta që është fituar me djersë, mund dhe me gjak", ka deklaruar imzot Dodë Gjergji, i cili ka ftuar popullin shqiptar që të ketë kujdes dhe të mos ndikohet nga padrejtësitë që mund të bëhen nga të tjerët. "Duhet të kihet kujdes që asnjë dështim yni apo padrejtësi që na bëjnë të tjerët të mos rrezikojë bashkëudhëtimin tonë drejt së ardhmes me popujt e tjerë të Evropës dhe rajonit, sepse e dimë mirë se si kemi pësuar kur kemi gabuar", ka thënë imzot Dodë Gjergji.

Po ashtu, ipeshkvi i Kosovës, Dodë Gjergji, ftoi popujt e Evropës të jenë më të drejtë në raport me shqiptarët dhe që të kenë më shumë besim në ta.

Për Krishtlindje uruan edhe përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se Krishtlindja është festë e jetës, paqes dhe dashurisë. "Në këtë kremte të madhe, që bashkon familjet tona, shprehim solidaritetin dhe kujdesin për të gjithë njerëzit në nevojë dhe nderojmë të gjithë ata që u sakrifikuan për lirinë dhe pavarësinë e popullit tonë", ka shkruar presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka vizituar katedralen "Nënë Tereza" në Prishtinë, së cilës i dhurova një skulpturë të Pjetër Bogdanit, vepër e punuar me mjeshtëri nga artisti ynë Ylber Krasniqi. "Ne ndihemi krenarë teksa kujtojmë që edhe në kohët më të vështira, Kosova pati dijetarë e mendimtarë të nivelit evropian siç ishte Pjetër Bogdani, simbol i aspiratës evropiane të kombit tonë. Në këtë natë të shenjtë, të gjithë të krishterëve të Kosovës, katolikë e protestantë, ua uroj Krishtlindjen, festën e madhe të shpresës, humanizmit dhe dashurisë njerëzore", ka thënë kryeparlamentari Veseli.

Ndërsa kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se Krishtlindja simbolizon lindjen e hyjnores dhe ripërtëritjen shpirtërore. "Si popull të një trungu, për mijëra vjet kemi festuar së bashku, andaj uroj që kjo traditë unike të rrënjoset si parim i përhershëm udhëzues për tërë shoqërinë tonë. Në këtë natë të shenjtë, u bashkohem lutjeve të besimtarëve katolikë që vlerat hyjnore të mishërohen ndër ne, përgjithmonë. Për shumë mot Krishtlindja", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook". Krishtlindja është festa më e rëndësishme në kalendarin e festave të krishtera dhe festohet çdo vit në natën mes 24 dhe 25 dhjetorit.





## Myftiu Tërnava uron ipeshkëv Dodë Gjergjin për Krishtlindje

PRISHTINË, 25 DHJETOR (ER) - Me rastin e Krishtlindjes, myftiu i Kosovës, Naim Tërnava, i ka dërguar ipeshkëvit Dodë Gjergjit telegram urim, në të cilin thekson se Krishtlindja është festë që në vete simbolizon lindjen, jetën e mbarësinë, si dhe porosinë për ndërtimin e shoqërisë së ndershme e të moralshme, parime këto humane për të cilat njerëzimi ka nevojë gjithherë. "Me rastin e festës së Kërshëndellave, kam nderin e kënaqësinë t'ju uroj e përgëzoj sinqerisht ju, të gjithë meshtarët tuaj, si dhe besimtarët e krishterë duke ju dëshiruar shëndet, mbarësi e lumturi. Kërshëndella është festë që në vete simbolizon lindjen, jetën e mbarësinë, si dhe porosinë për ndërtimin e shoqërisë së ndershme e të moralshme, parime këto humane për të cilat njerëzimi ka nevojë gjithherë. Zotni Ipeshkëv, festat fetare te ne gjithherë kanë qenë momente që na kanë bashkuar në të mirë, na kanë bërë më humanë, më unikë e më të dashur dhe nëpërmjet këtyre vlerave edhe kemi ndërtuar e kultivuar respektin, dashurinë, mirëkuptimin, ndërgjegjësimin, paqen e qetësinë. Zotni Ipeshkëv, nëpërmjet jush uroj e përgëzoj edhe të gjithë praninë ndërkombëtare katolike në Kosovë. Duke ju përshëndetur, ju dëshiroj shëndet, mbarësi e lumturi", është thënë në telegramin e urimit të Tërnavës.

# Gashi i ofron mbështetje BIK-ut në Kastriot

KASTRIOT, 25 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Kastriotit, Xhafer Gashi, ka pritur në takim kryetarin e Bashkësisë Islame në këtë komunë, Behar Mjekiqi, me të cilin kanë biseduar për projektet që pritet të realizohen vitin e ardhshëm. Gjatë këtij takimi Gashi i ka ofruar mbështetje Mjekiqit në projektet e përbashkëta në mes të këtyre dy institucioneve. "Prita në një takim pune kryetarin e BIK-ut në Obiliq, Behar Mjekiqi dhe stafin e tij. Biseduam në lidhje me projektet që pritet të realizojmë për vitin e ardhshëm, njëkohësisht u ofrova mbështetje në lidhje me projektet e përbashkëta të komunës dhe BIK-ut, në interes të qytetarëve të Kastriotit", ka shkuar Gashi në llogarinë e vet në "Facebook".





# Haziri e vlerëson 'Fluidin' si perandori të suksesshme prodhuese

GJILAN, 25 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka vizituar prodhuesit e mëdhenj të Gjilanit siç është rrjeti i produkteve të shumta që prodhohen në fabrikën "Fluidi" dhe kompaninë për prodhimin e ambalazhimit "Flexograf".
Haziri ka thënë se "Fludi" me kompanitë përcjellëse kanë ndërtuar "perandori" të prodhimit, duke qenë gjeneruesit më të mëdhenj të vendeve të punës. "Ky është prodhuesi më i madh edhe përtej kufijve të Kosovës, me prodhim të pijeve joalkoolike dhe produkteve të tjera të lëngjeve e deri te sektori i vajit ushqimor. Kjo kompani, krahas prodhimit dhe punësimit më të madh në Gjilan, është edhe investitorja më e madhe dhe lus të gjithë qytetarët që bashkërisht ta forcojmë zinxhirin e konsumit, blerjes dhe qarkullimit e rritjes së përbashkët të zhvillimit të sektorit privat në vendin tonë", ka thënë kryetari derisa ka qëndruar në fabrikën e 'Fluidit'", ka thënë Haziri. Kurse në vizitën tjetër në "Flexograf", Haziri ka thënë se këtu shtypen ambalazhet për më shumë se një mijë biznese e prodhues të ndryshëm për Kosovën dhe regjionin. "Sa i përket prodhimit, Gjilani këtë vit ka konfirmuar se është shembulli më i mirë i zhvillimit lokal ekonomik. Derisa qytetet e tjera dhe komunat e tjera e kanë të zhvilluar tregtinë, por në aspektin e prodhimit ne prijmë pas Prishtinës. Sektori i përpunimit të ushqimit, sektori i agrobiznesit dhe prodhimeve të tjera janë fushat në të cilat dominon Gjilani. 'Flexograf' mbulon 70 për qind të tregut të Kosovës dhe është një prodhues specifik", ka thënë Haziri.
Ndërsa pronari i "Fluidit", Fejzulla Mustafa dhe ai i "Flexograf", Berat Mustafa, kanë shprehur falënderimin e tyre për përkujdesjen që kryetari Haziri është duke treguar për të gjitha bizneset e Gjilanit.



# Klubi Rotarian 'Çabrati' dhuron tetë laptop për QMF-të e Gjakovës

Gjakovë, 25 dhjetor (ER) - Klubi Rotarian Gjakova - "Çabrati", në bashkëpunim me Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në kuadër të projektit të Telemedicinës në Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) të Komunës së Gjakovës, kanë organizuar punëtorinë dhe tryezën e punës me temë "Përfitimet nga telemedicina dhe zbatimi i saj në sektorin primar në QMF-të e Komunës së Gjakovës". Pjesëmarrës në këtë tryezë kanë qenë të pranishëm mjekë të QMF-ve, të spitalit të përgjithshëm, përfaqësues nga Klubi Rotarian Gjakova - "Çabrati" dhe Komuna e Gjakovës. Gjatë takimit drejtoresha e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Adelina Shehu-Kola, ka njoftuar të pranishmit mbi projektin dhe bashkëpunimin me klubet rotariane në fushën e mjekësisë si dhe ka falënderuar Klubin Rotarian Gjakova -"Çabrati" për kontributin e vazhdueshëm për avancimin e sektorit shëndetësor. Fleta Baraku, kryetare e Klubit Rotarian Gjakova - "Çabrati", ka njoftuar të pranishmit mbi ecurinë e projektit si dhe ka prezantuar pajisjet e telemedicinës dhe përfitimet nga implementimi i tyre në praktikë. Në fund të kësaj tryeze, menaxheri i këtij projekti, Butrint Batalli, ka dorëzuar edhe tetë laptopë për të gjitha QMF-të.

# Komuna e Prishtinës ndan 120 bursa për studentë

PRISHTINË, 25 DHJETOR (ER) - Komuna e Prishtinës do të ndajë 120 bursa për studentët që studiojnë në universitetet publike të Kosovës për vitin akademik 2018/2019. Konkursi për ndarjen e bursave do të mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik. Aplikacioni i kërkesës për burës i plotësuar duhet të dorëzohet në sportelet e katit përdhes të Komunës së Prishtinës (ndërtesa e vjetër), çdo ditë pune prej orës 10:00 deri 15:00.



# Shqipëria ia merr primatin Serbisë për t'i shitur mallra Kosovës

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 25 DHJETOR - Të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) për tregtinë e jashtme të Kosovës tregojnë për një deficit tregtar më të lartë për 4.2 për qind në muajin nëntor 2018, në raport me muajin e njëjtë të vitit 2017. Përkthyer në shifra, sivjet deficiti është 240,2 milionë euro e vjet ishte 230,5 milionë.

Në muajin nëntor nga Kosova dolën mallra në vlerë mbi 34 milionë euro, e erdhën mallra në vlerë rreth 275 milionë euro. "Eksporti i mallrave në muajin nëntor 2018 kishte vlerën 34.7 milionë euro, ndërsa importi 274.9 milionë euro, ku është një rritje prej 15.4 përqindësh për eksport dhe një rritje prej 5.5 përqindësh për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017", thuhet në njoftimin e ASK-së,

Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit, 36.4 për qind e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre, 13.5 për qind produktet minerale, 12.8 për qind plastika, goma dhe artikujt prej tyre, 8.1 për qind ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, 6.4 për qind prodhimet bimore, 3.8 për qind artikujt e ndryshëm të prodhuar, 3.2 për qind tekstili dhe artikujt prej tij etj.

Mallrat që erdhën më shumë në Kosovë ishin produkte minerale, makineri e pajisje mekanike. "Ndërsa, sipas të dhënave të grupeve kryesore për import: 16.9 për qind e përbëjnë prodhimet minerale, 12.2 për qind makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike, 10.9 për qind ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, 10.3 për qind metalet bazë dhe artikujt prej tyre, 7.8 për qind mjetet e transportit, 6.9 për qind plastika, goma dhe artikujt prej tyre, 6.4 për qind e përbën tekstili dhe artikujt prej tij, 6.0 për qind prodhimet e industrisë kimike etj", është bërë me dije në këtë njoftim.

Në muajin nëntor Kosova eksportoi mbi 10 milionë euro mallra drejt vendeve të Bashkimit Evropian, me partner kryesor Gjermaninë. "Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 10.4 milionë euro, ose rreth 30.2 për qind e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 29.6 përqindësh. Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE janë: Gjermania (8.5 për qind), Holanda (4.2 për qind), Sllovenia (3.6 për qind) dhe Italia (3 për qind)", është theksuar në njoftimin e ASK-së. Kurse importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 126 milionë euro, ose 45.8 për qind e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 9.8 për qindësh. Importet me pjesëmarrje më të lartë ishin nga Gjermania 11 për qind, Italia 5.1, Greqia 4.1, Franca 3.7, Sllovenia 3.5 për qind etj.




### Shqipëria partneri kryesor i Kosovës në shkëmbimin në vendet e CEFTA-s

"Në muajin nëntor 2018 eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 15.3 milionë euro, ose 44.3 për qind e eksporteve të përgjithshme, me një rënie prej 1.6 përqindësh. Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s janë: Shqipëria (16.6 për qind), Maqedonia (10.5 për qind), Serbia (8.3 për qind) dhe Mali i Zi (6.9 për qind)", tregojnë statistikat e ASK-së.

Ndërsa importet nga vendet e CEFTA-s në muajin nëntor 2018 arritën në 55.8 milionë euro, ose 20.3 për qind e importeve të përgjithshme, me një rënie prej 23.6 përqindësh. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Shqipëria 7.4 për qind, Serbia 5.6, Maqedonia 5.5 dhe Bosnja e Hercegovina me 1.1 për qind.

"Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 8.8 milionë euro, ose 25.5 për qind. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport vlen të përmenden India (14.3 për qind) dhe Zvicra (7.8 për qind)", thuhet në njoftimin e ASK-së.

Ndërkaq importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 93 milionë euro, ose 33.9 për qind. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin Turqia 11.2 për qind dhe Kina 10.3 për qind.

# KEDS-i reagon pas dëmeve të shkaktuara nga moti i lig

PRISHTINË, 25 DHJETOR (ER) - Me anë të një njoftimi për media, KEDS-i ka bërë me dije se ka angazhuar rreth 300 punëtorë me makineritë shtesë në terren për t'i rregulluar dëmet e mëdha që kanë shkaktuar një ditë më parë të reshurat, erërat dhe presionet atmosferike në rrjetin distributiv. "Në afat të shkurtër kohor, gjendja tanimë është përmirësuar pothuajse në gjithë vendin. Sipas informatave të ekipeve në terren, falë përkushtimit dhe punës së pandërprerë deri në orët e vona të natës së kaluar dhe duke vazhduar edhe sot, në kushte jashtëzakonisht të rënda, në një terren jo të përshtatshëm, KEDS-i ka arritur t'i rregullojë pothuajse të gjitha prishjet", është bërë me dije në njoftimin për media.

KEDS-i ka theksuar se varësisht nga niveli dhe lloji i prishjes, disa nga prishjet kanë marrë më shumë kohë për t'u rregulluar e disa janë rregulluar më shpejt. "Ne falënderojmë të gjithë punëtorët e KEDS-it që vazhdojnë të qëndrojnë në terren si dhe qytetarët e shumtë që kanë lajmëruar prishjet dhe kanë asistuar me qëllim të sanimit të gjendjes në afatin më të shkurtër të mundshëm kohor", është thënë në njoftimin për media të KEDS-it.



# Pozita gjeostrategjike e kufirit të Kosovës me Serbinë



Shkruan: Prof. ass. dr. Sabri KIÇMARI

Pozita gjeografike e Republikës së Kosovës është mjaft komplekse. E gjendur në zemër të Evropës Juglindore (që padrejtësisht quhet Ballkan), Republika e Kosovës kufizohet nga dy vende anëtare të NATO-s nga Shqipëria në jug dhe jugperëndim, dhe nga Mali i Zi në perëndim, si dhe nga një vend që aspiron anëtarësimin në NATO, Maqedonia në juglindje.

Me të tri këto vende fqinje Republika e Kosovës ka marrëdhënie shumë të mira dhe ndan një numër vlerash të përbashkëta në fushën e sigurisë dhe orientimit euroatlantik. Por, në pjesën më të madhe të kufijve të saj, në veri dhe lindje, Republika e Kosovës kufizohet me Republikën e Serbisë, me të cilën nuk i ndan të njëjtat vlera në fushën e sigurisë dhe nuk ka orientim të njëjtë eurotlantik. Në fakt, kufiri verior dhe lindor i Kosovës sot i ndan dy trende gjeostrategjike në fushën e sigurisë: Lindjen me Perëndimin. Pra, në rrafshin gjeostrategjik, Kosova është në një situatë identike me Gjermaninë dhe Austrinë në kohën e Luftës së Ftohtë. Serbia ka një orientim lindor në fushën e sigurisë. Ajo është e varur në fushën ushtarake dhe të industrisë së armatimit nga Rusia.

Republika e Serbisë paraqet një paradoks të llojit të vet në Evropë: në njërën anë ka shpallur vullnetin për t'u pranuar në Bashkimin Evropian, në anën tjetër është në partneritet të ngushtë ushtarak me Rusinë. Është i vetmi vend që përgjatë procesit të negocimit për pranim në BE, organizon ushtrime ushtarake me Rusinë dhe Bjellorusinë, blen armatim nga Rusia dhe ka hapur një qendër humanitare ruso-serbe që, në fakt, është një qendër spiunazhi rus në Nish. Zyrtari i lartë i Departamentit të Shtetit të ShBA-së, Hoyt Yee, pati paralajmëruar para Subkomitetit për Çështje të Jashtme të Senatit të ShBA-së, se "nëse Serbia e lejon Rusinë të krijojë një qendër të tillë spiunazhi në territorin e saj, ajo do ta humbë kontrollin në një pjesë të territorit të saj".

Nga 18-28 qershor 2018 Serbia mori pjesë në ushtrimet ushtarake me Rusinë dhe Belorusinë, me një emërtim agresiv pansllavist "Vëllazëria Sllave".

Më 28 qershor 2018 Serbia bleu dy helikopterë ushtarak rusë Mi17 për 25 milionë euro, kurse në dhjetor 2016, Qeveria serbe nënshkroi një marrëveshje për ndihmë ushtarako-teknike me Rusinë, si rezultat i së cilës përfitoi gjashtë avionë luftarak Mikoyan MiG-29, 30 tanksa moderne T-72 dhe 30 automjete të blinduara BRDM-2.

Presidenti serb Vuçiq, duke u fotografuar pranë aeroplanëve luftarak deklaroi se "kam qarë kur pashë dhe dëgjova zhurmën e tyre".

Njoftime nga Rusia bëjnë me dije se presidenti rus, Vladimir Putin, do ta vizitojë Beogradin më 17 janar 2019, me ç'rast pritet të bisedojë detale të mundësisë së vendosjes së një kontingjenti të trupave ushtarake ruse në Serbi. Kjo është analizuar në detale në një mbledhje të Këshillit të Sigurisë Nacionale të Federatës Ruse më 17 dhjetor 2018.

Vendosja e trupave elitore ushtarake ruse në Serbi do të ndikojë në forcimin e statusit gjeostrategjik të kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë si kufi ndarjeje në mes të Lindjes dhe Perëndimit.

Prandaj, është e vetëkuptueshme miratimi, me të cilin administrata e ShBA-së dhe e disa vendeve anëtare të NATO-s reaguan, kur më 14 dhjetor 2018 Kuvendi i Republikës së Kosovës votoi shndërrimin e FSK-së në ushtri të Kosovës. Serbia është i vetmi vend në rajon që ka refuzuar të aplikojë sanksione kundër Rusisë pas cenimit të integritetit territorial të Ukrainës dhe pushtimit të Krimesë në vitin 2015. Edhe në fushën ekonomike ndërthurja është e madhe: Kompania më e madhe serbe e naftës, Naftna Industrija Serbie, është blerë nga Gazpromi rus, i cili eksporton gazin e vet në Serbi. Në rast se Serbia do të pranojë vendosjen e trupave ruse në territorin e saj, Bashkimi Evropian do të gjendet në një pozitë tejet të palakmueshme: të distancohet për të pranuar në radhët e saj një vend me prezencë ushtarake ruse, i cili e konsideron veten zonë ruse të influencës.

Qëndrimi i Serbisë ndaj Kosovës është vetëm një nga shumë dimensione të orientimit të saj joperëndimor. Qeveria serbe po e shijon yshtjen e madhe të institucioneve të BE për ta shkëputur Beogradin nga Moska dhe orientuar atë drejt Brukselit. Kjo yshtje është paradoksale dhe instrumentale. Një mision i tillë është i pamundur. Udhëheqësit e institucioneve të BE dhe vendet anëtare të BE duhet ta kuptojnë se orientimi i Serbisë drejt Bashkimit Evropian është një farsë, një lloj aktrimi. Baza e këtij interesimi, të shfaqur publikisht, është interesi ekonomik. Rusia nuk mund t'i ofrojë Serbisë, atë që i ofron BE dhe integrimi në BE, në fushën ekonomike dhe sociale: investimet dhe mbështetjen financiare dhe ekonomike. Por, Serbia ndan me Rusinë një aleancë tradicionale religjioze, politike, ushtarake dhe kulturore, e cila është shumë e fuqishme. Prandaj, vlerat politike demokratike evropiane nuk janë në akord me linjën politike të Republikës së Serbisë. Bashkimi Evropian do të gjendet i kurthuar thellë në paradoksin serb. Kosova dhe Bosnja e Hercegovina janë duke vuajtur shumë nga ky paradoks. Ai nuk zgjidhet duke e lajmitur Serbinë. Politika e jashtme dhe politika e mbrojtjes së Republikës së Kosovës duhet t'i kenë parasysh këto zhvillime. Orientimi perëndimor i partive politike dhe shoqërisë së Kosovës, si vlerë e jashtëzakonshme, duhet ruajtur jo vetëm sa për formë, por edhe në përmbajtje. Është e domosdoshme që ky orientim strategjik të materializohet jo vetëm në rrafshin politik e ushtarak, taktik e strategjik, por edhe në atë kadrovik. Politikanët e vendit tonë duhet të kujdesen për gjuhën që përdorin në raport me BE-në, NATO-n, ShBA-në dhe Britaninë e Madhe. Ata janë aleatë tanë të natyrshëm dhe të tillë do të mbeten.



## Veseli i kërkon Thaçit ta dekorojë Ahmet Delinë me titullin 'Hero i Kosovës'

PRISHTINË, 25 DHJETOR (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka kujtuar të martën, në ditën e rënies, Ahmet Delinë. Ai ka vlerësuar lart rolin e Ahmet Delisë në mbrojtjen e popullatës civile nga njësitet ushtarake serbe.

Kryeparlamentari Veseli ka kërkuar nga presidenti Hashim Thaçi që ta dekorojë Ahmet Delinë me titullin "Hero i Kosovës". "Sot, në datën e rënies, përkujtojmë trimin legjendar të Prekazit, Ahmet Delinë. Rënia e tij epike në mbrojtje të popullatës civile të sulmuar nga njësitet ushtarake serbe, në kujtesën tonë kolektive mbeti shembull unik i sakrificës për atdheun. I rekomandoj presidentit Thaçi që Ahmet Delinë ta dekorojë me titullin 'Hero i Kosovës'. Ne sot jemi të lirë falë sakrificave mbinjerëzore të së kaluarës", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

# Narkoza e vizave - mit apo realitet (5)



Shkruan: Agron HOTI

## Ç'na thoshte BE-ja?

Deri më tani janë të panumërta takimet me zyrtarë të BE-së dhe shteteve anëtare të saj ku na thuhej se vizat do të hiqen shpejt, bile-bile kishte shumë prej tyre në takime të mbyllura thoshin se tetori i 2018-s është data më e largët. Ndërsa publikisht vazhdimisht na thuhej që "sa më shpejt që plotësojmë kriteret, aq më shpejt do të hiqen vizat". Edhe pse na vunë dyfish kritere më shumë sesa vendeve të rajonit, Kosova, pavarësisht prej vështirësive, ia arriti t'i plotësojë të gjitha kriteret. Dhe këtë e konfirmoi publikisht dhe qartazi vetë BE-ja. Askush nuk e detyroi. Pra, ishte puna e institucioneve të Kosovës ajo që e shtyri BE-në të japë vlerësimin pozitiv, e jo mospuna. Fundja, pse Komisioni Evropian konfirmoi përmbushjen e kritereve, kush e detyroi?! Në qoftë se kanë konsideruar që ende s'kemi plotësuar kriteret, atëherë pse nuk e thanë këtë qartë dhe haptazi, fundja shqiptarët nuk kanë marrë asgjë shpejt nga Evropa në qoftë se ka ndonjë popull që ka përfituar më së voni nga zhvillimet historike pozitive politike dhe ekonomike evropiane, rasti i popullit shqiptar është më tipiku. Ndërsa, kurbanizimi i vazhdueshëm i shqiptarëve për interesa të fqinjëve greko-sllavë ka qenë përditshmëri e zezë për shqiptarët pa marrë parasysh se në cilën pjesë të Ballkanit kanë jetuar.

Brenda për brenda BE-së kishte edhe deklarime interesante. Përderisa institucionet e Kosovës po punonin në plotësimin e kritereve të kërkuara një nga një, paralelisht me këtë proces, përfaqësues të institucioneve të BE-së kritikonin vetë institucionet e BE-së për vonesat që shkaktoheshin nga këto të fundit. Bile-bile Shtete Anëtare të ndryshme të BE-së, kryesisht të vendeve të fuqishme, ishin dhe janë shumë kritikë ndaj institucioneve të BE-së, diçka e pakuptueshme për qytetarët e Kosovës, të cilët BE-në e shohin si strukturë gati e përkryer.

Kështu Tanja Fajon dhe Ulrike Lunaçek, duke parë vonesat e paarsyeshme të Komisionit Evropian në publikimin e raporteve për plotësim të kritereve që bëheshin kohë pas kohe, qysh në fillim të vitit 2014 i patën kërkuar urgjentisht zonjës Cecilia Malmstrom, atëbotë Komisionare për Çështje të Brendshme, që "Komisioni Evropian deri në fund të vitit 2014 të hiqte vizat për qytetarët e Kosovës, sepse çështje e vizave ishte më e cenueshmja për qytetarët e Kosovës duke pasur parasysh që përparësia e lëvizjes së lirë nuk kishte çmim dhe se qytetarët e Kosovës e meritonin atë".

Më tutje në maj 2016, znj. Urike Lunaçek, zëvendëspresidente e atëhershme e Parlamentit Evropian e ngarkuar me Ballkanin Perëndimor dhe Raportuese për Kosovën në Parlamentit Evropian, thoshte që "Komisioni Evropian kishte pritur që sa vite dritën e gjelbër për liberalizimin e vizave për shtetin më të ri në Evropë dhe se kjo tejzgjatje do të shpinte në një izolim të papranueshëm për qytetarët e Kosovës duke ditur që liria e lëvizjes veç ishte duke u gëzuar nga qytetarët e të gjitha vendeve të rajonit që nga fundi i vitit 2010".

Më tej ajo thoshte që "liberalizimi i vizave nuk është një e drejtë, por diçka që bazohet në merita, prandaj Qeveria e Kosovës kishte bërë mjaft shumë në përmbushjen e kritereve të kërkuara dhe se topi tanimë ishte të ministrat e brendshëm të shteteve anëtare të BE-së dhe Parlamenti Evropian që të mbanin premtimin dhe të arrinin ujdi".

Në vazhdën e deklarimeve pro liberalizimit të vizave është edhe deklarata e zonjës Frederica Mogerini, Përfaqësuese për Politikë të Jashtme të BE-së, e cila në shtator 2017 në një takim me Komisionarin për Zgjerim, Johanes Hahn, dhe Zëvendëskryeministrin Pacolli, kishte deklaruar që "me formimin e Qeverisë së re, Kosova ishte në pozitë të mirë për të lëvizur përpara në përmbushjen e vetëm dy kritereve të mbetura për liberalizimin e vizave, më konkretisht ratifikimin e marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi dhe krijimin e një regjistri të qëndrueshëm të rasteve të shënjestruara që kishin të bënin me luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar".

Ndërkohë duke folur për rëndësinë e vizave dhe për të mbajtur gjallë perspektivën evropiane për rajonin e Ballkanit Perëndimor, Përfaqësuesja për Politikë të Jashtme dhe Siguri të BE-së, Frederika Mogerini, Komisioneri për Zgjerim dhe Fqinjësi, Johannes Hahn dhe Presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker kishin ndërmarrë një vizitë të përbashkët në rajon dhe Kosovë në shkurt të këtij viti (2018). E tëra kjo po bëhej në një kohë kur evropeizimi kishte filluar të shënonte zbehje jo vetëm në BE, por edhe Ballkan. Dhe pikërisht më 28 shkurt 2018 Juncker pati thënë në Prishtinë se "nuk ndihej mirë që kosovarët janë të vetmit që nuk mund të udhëtojnë, ata duhet të kishin të drejta të njëjta, me kushtin që të ratifikonin marrëveshjen e demarkacionit dhe të vazhdonin luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar". Kurse, institucionet e Kosovës bënë pikërisht atë që kërkonte Juncker, Mogerini dhe Hahn, pra ratifikuan me shumë mund demarkacionin dhe vazhduan me luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar, aspekte këto që u vlerësuan qartë nga Komisioni Evropian, prandaj edhe u dha rekomandimi pozitiv në korrik 2018.

Në vazhdën e deklaratave premtuese të Zyrtarëve të Lartë të BE-së është edhe ajo e Komisionerit Avramopoulos, i cili derisa po publikonte raportin pozitiv për viza, më 18 korrik 2018 deklaronte se "pas disa viteve pune dhe përpjekjeje serioze, Komisioni Evropian konfirmonte se Kosova kishte plotësuar të gjitha kriteret për liberalizimin e vizave dhe inkurajonte Këshillin e Ministrave të BE-së dhe Parlamentin Evropian që të ecnin tutje me propozimin e Komisionit Evropian duke qenë personalisht i bindur që ishim shumë afër regjimit pa viza, i cili pritej të ndodhte shpejtë".

E maja e majës së premtimeve të BE-së ishte deklarata e zonjës Mogerini më 27 shkurt 2018 kur ajo në televizionin publik të Kosovës thoshte shumë qartë se "nëse ratifikohet demarkacioni, liberalizimi i vizave është gati". Si mund të thonë sot zyrtarët e BE-së se nuk kemi dhënë premtime?! Kjo është një nga deklaratat më të qarta të ajkës së BE-së dhe konform kësaj është dashur të reflektohet. Bile bile deklarata e Mogerinit në shkurt 2018 ishte dhënë ende pa u dhënë rekomandimi pozitiv nga ana e Komisionit Evropian (në korrik 2018) dhe me këtë deklaratë me siguri që nuk mendoheshin vite, por vetëm disa muaj.

Tutje më 13 nëntor 2018 në një intervistë për Radion Evropa e Lirë, Tanja Fajon thotë që "insiston që vendet anëtare të përdorin të njëjtat standarde për Kosovën siç kanë qenë vitet e fundit për Ukrainën dhe Gjeorgjinë. Pasi kushtet të plotësohen ne duhet të ecim tutje. Nëse këto principe vihen në pikëpyetje atëherë ne humbin kredibilitetin".

Më tutje Fajon thotë që "është e shqetësuar me disa zhvillime dhe deklarata lidhur me liberalizimin e vizave, siç ishte ajo e kancelarit austriak Sebastian Kurz gjatë vizitës në Prishtinë. Është e papranueshme sesi disa politikanë po mundohen që të politizojnë edhe më tutje procesin, duke imponuar kushte të reja dhe në këtë mënyrë të vonojnë heqjen e vizave për qytetarët e Kosovës".

Pra, ishin të panumërta takimet e Zyrtarëve të Lartë të Institucioneve të Kosovës me homologët e tyre nga Shtetet Anëtare të BE-së që nga viti 2012 (kur na u dha Udhërrëfyesi për Liberalizim të Vizave) e deri më sot ku na thuhej se sa më shpejtë që plotësoni kriteret aq më shpejtë do të lëvizni pa viza. Nga pothuaj të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së na thuhej që sapo Komisioni Evropian ta konfirmojë përmbushjen e kritereve, qytetarët e Kosovës shumë shpejtë do të gëzojnë këtë të drejtë elementare ashtu siç që sa vite e gëzojnë të gjitha vendet e rajonit.

Dhe prapë, kur kriteret u plotësuan Shtetet Anëtare të BE-së sillen e mbështillen duke thënë se gjoja fryma në BE është shumë e komplikuar dhe se çdo vonesë eventuale në këtë drejtim nuk është për faj të Kosovës, por për shkak të problemeve multidimensionale që kanë kapluar BE-në gjithandej.

Sigurisht që neve nuk na mbetet rrugë tjetër, pra institucionet e Kosovës edhe pse e kuptojnë gjendjen e përgjithshme dhe të rëndë brenda BE-së patjetër që do të vazhdojnë punën në të gjitha drejtimet e mundshme drejt integrimit evropian, ashtu sikundër që presin nga BE dhe Shtetet Anëtare të saj të respektojnë parimet dhe mbajnë premtimet.

Vazhdimisht na thuhej nga BE-ja që procesi i liberalizimit të vizave është tërësisht teknik, ndërkohë që tashmë na doli se procesi na qenka krejt politik dhe se, sipas deklaratës së kryeministrit austriak, Sebastian Kurz, të bërë më 6 nëntor 2018 në Prishtinë, na del se "ende nuk paska konsensus mes shteteve anëtare të BE-së për liberalizimin e vizave". Në qoftë se nga institucionet e Kosovës kërkohet përgjegjësi në këtë proces, atëherë e duhet që edhe BE-ja ta marrë përgjegjësinë për shtyrje maratonike të këtij procesi?!



**(Vijon)**

# Trumpi dhe demokratët vazhdojnë përplasjet për murin me Meksikën

Udhëheqësi i Demokratëve në Senat, Chuck Schumer dhe ajo në Dhomën e Përfaqësuesve, Nancy Pelosi, e akuzuan Trumpin se ishte nën ndikimin e konservatorëve republikanë për mbylljen e pjesshme të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara


Carolyn Kaster (AP)

UASHINGTON, 25 DHJETOR - Presidenti Donald Trump dhe përfaqësuesit demokratë më të lartë në Kongres u përplasën nëpërmjet deklaratave sërish mbi mbylljen e pjesshme të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara, pa dhënë asnjë shenjë të përpjekjeve për t'i rihapur agjencitë e mbyllura nga një bllokim politik mbi kërkesën e Trumpit për fondet e ndërtimit të murit kufitar me Meksikën.
Udhëheqësi i Demokratëve në Senat, Chuck Schumer dhe ajo në Dhomën e Përfaqësuesve, Nancy Pelosi, e akuzuan Trumpin se ishte nën ndikimin e konservatorëve republikanë si dhe sulmuan Shtëpinë e Bardhë se po thonë gjëra të ndryshme për atë që presidenti do ta pranonte ose nuk do të pranonte, raporton "Reuters". "Është festa e Krishtlindjes dhe presidenti Trump po e zhyt vendin në kaos", thanë Schumer dhe Pelosi në një deklaratë të përbashkët, pasi mbyllja e pjesshme e qeverisë ka hyrë në ditën e tretë.
Shtëpia e Bardhë nuk u përgjigj rreth kësaj deklarate. Por, të hënën në mbrëmje, përderisa po bisedonte me fëmijë përmes telefonit për Festën e Krishtlindjes, presidenti Trump u pyet nga gazetarët nëse është arritur progres në bisedimet për financimin e qeverisë. "Asgjë e re. Neve na duhet siguria e kufijve", deklaroi ai. Trumpi, i cili për shkak të mbylljes së pjesshme të qeverisë ka anuluar udhëtimin për Krishtlindje në resortin e tij në Florida, kishte planifikuar një bisedë për sigurinë në kufij me zyrtarët e lartë të sigurisë në ShBA. Më pas, Trumpi shkroi një mesazh në "Twitter": "Unë jam në Zyrën Ovale dhe sapo dhashë një kontratë për një pjesë tjetër të madhe të murit në Teksas".Ai nuk dha detaje dhe Shtëpia e Bardhë nuk iu përgjigj menjëherë një kërkese për të komentuar mbi atë se çfarë konkretisht po thoshte presidenti Trump përmes këtij mesazhi.
Më herët presidenti tha në "Twitter" se ai ishte i vetëm në Shtëpinë e Bardhë duke pritur që demokratët të kthehen dhe të bëjnë një marrëveshje për sigurinë e kufijve. Secila palë ka fajësuar tjetrën për mbylljen e qeverisë, pa asnjë shenjë të ripërtëritjes së bisedimeve midis ligjvënësve dhe Shtëpisë së Bardhë.
Të dielën, një ndihmës i lartë i presidentit Trump tha se mbyllja mund të vazhdojë deri më 3 janar, kur Kongresi i ri mblidhet dhe demokratët marrin kontrollin.
Financimi për rreth një të katërtën e programeve federale - duke përfshirë departamentet e Sigurisë Kombëtare, Drejtësisë dhe Bujqësisë - ka skaduar në mesnatë të premten.
Pa një marrëveshje për ta thyer bllokimin mbi kërkesën e Trumpit për pesë miliardë dollarë për një mur përgjatë kufirit amerikan me Meksikën, mbyllja e qeverisë ka gjasa të vazhdojë në fillim të vitit të ardhshëm.
Ndërtimi i murit ka qenë një ndër premtimet më të përsëriturа të Trumpit gjatë fushatës, por demokratët e kanë kundërshtuar fuqishëm.
Gjatë fundjavës së kaluar zyrtarë të Shtëpisë së Bardhë iu kishin bërë një ofertë demokratëve për financimin e sigurisë së kufijve, që arrinte një vlerë të mesme mes propozimit të tyre prej 1.3 miliard dollarësh dhe kërkesës së presidentit Trump prej 5 miliardë dollarësh. Raportet e medieve thanë se zëvendëspresidenti Mike Pence kishte propozuar 2,1 miliardë dollarë financim për murin në kufi me Meksikën.

# Papa Françesku uron për vëllazëri mes njerëzve dhe vendeve

VATIKAN, 25 DHJETOR - Në mesazhin e tij të Krishtlindjes për qytetin dhe botën, Papa Françesku tha se urimi i tij këtë vit ishte për vëllazëri mes individëve të çdo vendi dhe kulture dhe shprehu shpresën se kjo do të sillte paqe mes izraelitëve dhe palestinezëve, në Siri dhe në Jemen. "Urimi im për një Krishtlindje të lumtur është një urim për vëllazëri", tha Papa duke iu drejtuar mbi një milion katolikëve në gjithë botën, në mesazhin e tij nga Bazilikata e Shën Pjetrit. "Vëllazëri mes individëve të çdo vendi dhe kulture. Vëllazëri mes njerëzve



me ide të ndryshme, por që gjithsesi respektojnë dhe dëgjojnë njëri-tjetrin. Vëllazëri mes njerëzve të besimeve të ndryshme", tha ai.
Papa më pas e ktheu vëmendjen te zonat me konflikt në botë, para së gjithash, në Lindjen e Mesme. Ai shprehu shpresën se lidhjet e vëllazërisë mund t'i ndihmojnë izraelitët dhe palestinezët që ta rifillojnë dialogun dhe të ndërmarrin një udhëtim të paqes që mund t'i japë fund një konflikti 70-vjeçar.
Ati i Shenjtë tha se shpresonte që Siria ta rigjente vëllazërinë pas gjithë këtyre viteve të gjata lufte. Ai i bëri thirrje komunitetit ndërkombëtar që të punonte me vendosmëri "për një zgjidhje politike që të mund t'i lërë mënjanë përçarjet dhe interesat politike, në mënyrë që populli sirian, veçanërisht ata që janë të detyruar ta lënë vendin e tyre dhe të kërkojnë strehim gjetiu, të mund të kthehen të jetojnë në paqe në vendin e tyre".
Papa foli edhe për Jemenin dhe shprehu shpresën që armëpushimi i ndërmjetësuar nga komuniteti ndërkombëtar të sjellë, më në fund, lehtësim për të gjithë fëmijët dhe njerëzit e rraskapitur nga lufta dhe uria.
Të hënën në mbrëmje papa festoi Meshën e Krishtlindjeve në Bazilikatën e Shën Pjetrit, ku morën pjesë dhjetëra mijëra veta.

## Merkeli në janar viziton Athinën

BERLIN, 25 DHJETOR - Kancelarja gjermane Angela Merkel do ta vizitojë Athinën, sipas të gjitha gjasave, më 10 dhe 11 janar, njoftojnë mediet greke. Arsyeja për vizitën dyditore, sipas medieve greke, është që të shprehë mbështetje për Qeverinë e Greqisë në lidhje me ratifikimin e Marrëveshjes së Prespës në Kuvendin e Greqisë dhe të dërgojë porosi pozitive pas daljes së Greqisë nga memorandumet.
Zgjedhja e datës nuk është e rastësishme: disa ditë më vonë, nëse nuk ndodh diçka e paparashikueshme, Qeveria e Zaevit do të mbarojë me revizionin e paraparë kushtetues, ndërkaq Marrëveshja e Prespës do të vijë në Kuvendin e Greqisë. Ashtu siç thonë informatat nga Gjermania, Merkeli dëshiron që me vizitën t'i japë mbështetje kryeministrit Aleksis Cipras, pasi marrëveshja hyn në fazën përfundimtare", shkruan gazeta greke "Katimerini" dhe rikujton se Berlini ishte aktiv në gjysmën e parë të këtij viti që Athina dhe Shkupi të arrijnë marrëveshje.
Sipas gazetës, Merkeli, përveçse do të ketë takim me kryeministrin dhe presidentin, pritet të takohet edhe me liderin e opozitës, gjegjësisht kryetarin e Demokracisë së Re, ndërkaq nuk përjashtohet mundësia që të takohet edhe me Grekët e Rinj.









# **BeyAb** for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.






E rrallë

## Kafe nga roboti




Ka shumë vende ku mund të pish kafe në San Francisko, por një kafene ofron ekspres dhe kapuçino të bëra nga një robot. Korrespondentja e "Zërit të Amerikës" Michelle Quinn ndaloi për të parë nëse një robot mund të bëjë vërtet një kafe të mirë. Ky është Robin, një robot barista, që mund të bëjë një ose pesë kapuçino për pak minuta.

FOTO E DITES



Nuset indiane ulen së bashku për një fotografi të grupit gjatë një martese masive në Sures. /AP/

E jashtëzakonshme

## Shkencëtarët zbulojnë akull në Mars



Një imazh i lëshuar nga Agjencia Evropiane e Hapësirës jep një vështrim mahnitës në atë që duket si një krater i mbushur me akull në Mars. Ky zbulim është mjaft i dukshëm edhe me sy të lirë. Shkencëtarët e ESA-së "European Space Agency" kanë publikuar një pamje të kraterit Korolev, me një gjerësi prej 82 kilometrash (50 milje) të mbushur me akull, që arrin afërsisht dy kilometra thellësi.

BARSOLETA E DITËS



**Djali: Babi, sa para do të më jepje po të merrja pesëshe!**
**Babai: Pesë euro.**
**Djali: Më jep vetëm një euro, se e kam marrë një
sh.**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**




**Në ora 16:00**

**"THE GRINCH" 3D,**

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney




**Në ora 17:30**

**"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D**

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston




**Në ora 19:30**

**"MORTAL ENGINES" 3D,**

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers




**Në ora 22:00**

**"HUNTER KILLER",**

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI** Ditë mjaft intensive në ambientin e punës. Nëse keni lënë gjëra pa zgjidhur mund t'ju mbivendosen.



**DEMI** Në mendjen tuaj vazhdon një mendim fiks që diku keni gabuar me një mik të ngushtë. U bë kohë që nuk flisni.



**BINJAKËT** Edhe pse të dyzuar në shumë çaste, sot do të arrini të shpëtoni situata mjaft delikate.



**GAFORRJA** Keni vendosur të mos pajtoheni me disa ngjarje që për ju kanë lënë shije të keqe. Do të ankoheni me zë të lartë për këtë fakt.



**LUANI** Ndjenjat tuaja karshi një personi kanë kohë që kanë filluar të lëkunden. Tashmë po jetoni dy realitete të ndryshme.



**VIRGJËRESHA** Çështjet financiare janë ato që ju shqetësojnë sot. Edhe pse ndiheni të stabilizuar e ardhmja ju tremb.



**PESHORJA** Kanë afruar te ju sot mjaft optimizëm dhe buzëqeshje. Do të mundoheni t'i shpërbleni këta persona.



**AKREPI** Ditët në vazhdim janë ditë relaksimi dhe ju mezi i kishit pritur. E gjithë ngarkesa e punës do të zhduket si me magji.



**SHIGJETARI** Një miku juaji do t'ju hapë sytë lidhur me një situatë të caktuar. Nuk e mendonit që mund të ishte kaq serioze.



**BRICJAPI** Nëse keni vendosur t'i ndryshoni gjërat për ju dhe familjen tuaj duhet ta ndani mendjen mirë. Vendimi është shumë i rëndësishëm.



**UJORI** Në këtë periudhë të gjithë ju që jeni në punë apo në shkollë nuk keni fare interes për të punuar. Çdo gjë ju çon larg në mendime.



**PESHQIT** Një ditë pa ndonjë emocion të veçantë kjo e sotmja. Do të keni mjaft kohë të lirë në dispozicion.

# Fejohet Robin Thicke



Robin Thicke and April Love Geary janë zyrtarisht të fejuar. Muzikanti 41-vjeçar ia parashtroi pyetjen të dashurës së vet 23-vjeçare gjatë darkës së Krishtlindjeve. Bukuroshja e ka ndarë me fansat e "Instagram"-it këtë lajm, duke postuar disa fotografi bardhezi të fejesës, së bashku me një video të Robinit, duke e bërë propozimin. "Po, po, 1 000 herë po", është përshkrimi që April e ka lënë në imazhin e postuar.

# Rita Ora kapet mat me të dashurin e ri




Nën atmosferën festive, këngëtarja me famë botërore Rita Ora ka dalë të shëtisë me të dashurin e ri. Ajo është fotografuar për herë të parë të dielën krah Andrew Garfield në Primrose Hill, Londër. Spekulimet për lidhjen romantike të Ritës me yllin e filmit Spider-Man nisën muajin e kaluar, rreth tre muaj pas ndarjes së saj nga të dashurin Andrew Watt. Muajin e kaluar një burim tha për "The Sun" se të dy ishin në fillim të historisë së tyre duke shtuar se nuk janë të sigurt për këtë marrëdhënie.



# Kida së shpejti me këngë të re

Pas "Merri krejt", Kida ka paralajmëruar këngën e re. Këngëtarja ka postuar fotografi në "Instagram" në instastory, mbi të cilën ka shkruar 'po vjen shumë shpejt'. Artistja nuk dha detaje të tjera përveç imazhit në studion e Zzap dhe Chris, producentët me të cilët Kida ka kontratë. Megjithatë, ajo që dihet është se këngëtarja do ta lëshojë projektin e ri gjatë vitit 2019, pasi ky vit veç përfundoi.

# Modeluesja i jep fund beqarisë, fejohet me të dashurin 16 vjet më të ri



Modeluesja e famshme Heidi Klum i ka thënë "po" propozimit të partnerit të saj Tom Kaulitz. 45-vjeçarja ka njoftuar me anë të rrjeteve sociale se ka pranuar propozimin e partnerit duke treguar unazën me diamant. Lidhja mes saj dhe 29-vjeçarit ka nisur në muajin mars. Tom është një muzikant dhe më parë ka pasur një martesë me Ria Sommerfeld që përfundoi në fillim të këtij viti.

# Organizimi i demonstratave në



Prof. Dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA

Demonstratat e vitit 1968 vërtet filluan në tetor, por vazhduan edhe në nëntor për të përfunduar në dhjetorin e vonë të vitit 1968, duke përfshirë gati të gjitha trojet ku jetonin shqiptarët në ish-Jugosllavi. Edhe shqiptarët që kishin përjetuar fatin e keq të ndarjes dhe kishin ngelur nën okupimin maqedonas, po ashtu ishin të pakënaqur me padrejtësitë e shumta që iu bënin. Ata nuk gëzonin të drejtat elementare dhe vazhdimisht jetonin nën presionin e dhunës e të terrorit. Në Maqedoni, edhe para, por edhe pas Plenumit të Brioneve, mjaftonte vetëm një shkëndijë e vogël që të eskalonte situata. Pas ngjarjeve të mëdha që ndodhën në Kosovë, në qytetin e Tetovës, shumë intelektualë, studentë e nxënës, morën përsipër të organizojnë demonstrata në përkrahje të kërkesave të vëllezërve të tyre nga Kosova.

Organizatorët e demonstratave në Tetovë ishin studentët nga Tetova, Gostivari e Kumanova të cilët studionin në Universitetin e Beogradit, Shkupit, Zagrebit dhe në disa fakultete të Prishtinës.

Organizatorë të demonstratave ishin atdhetarët e dëshmuar që kishin qenë aktivë edhe më përpara. Në ballë të tyre, pa hezituar se çfarë do të ndodhë në ditët në vijim, dolën patriotët e shquar: Mehmet Gega nga Tetova që, sipas Sheradin Berishës, thuhej se ai edhe në vitin 1955 ishte dënuar me 10 vjet burg për shkak se kishte qenë kundër shpërnguljes së shqiptarëve për Turqi; mësuesi Sejdi Kryeziu nga fshati Rogaqicë i Kamenicës, Hysni Qemal Sherifi që më 1963 kishte qenë udhëheqës i grupit patriotik e revolucionar "Flamuri"; studentët Faik Mustafa nga fshati Shipkovicë, Ramadan Sinani nga fshati Gajre, Hysen Xhevat Kalishta, Abdyl Menaf Rustemi, Arbër Xhaferi, Fehmi Rufati etj.

Pas përfundimit të demonstratave në Tetovë organet e ndjekjes nuk humbën kohë, menjëherë filluan në mënyrë të organizuar t'i arrestonin organizatorët dhe pjesëmarrësit e demonstratave.

## 1. Organizatorët e demonstratave të Tetovës para gjyqit

Me kërkesën e prokurorit publik të Qarkut në Shkup, mr. Vanço Proevzki, para trupit gjykues të Gjykatës së Qarkut po të këtij qyteti, në bazë të aktakuzës me nr. 1225/68 të datës 18. 4. 1969 u ngre padia kundër Memetriza Murtezani, Faik Mustafa, që të dy nga Tetova, për veprën penale kundër popullit dhe shtetit nga neni 117, lidhur me nenin 100 dhe 101, alineja 1 të Ligjit Penal, si dhe kundër të akuzuarve: Abdyl Selam Selami, Ramadan Sinani, Fehmi Rufati, Xhemil Mustafa, Agim Xhaferi, Abdyl Menaf Rrustemi, Hysein Xhevat Hyseini, Hisni Qemal Sherifi. Refik Murati dhe Nexhbedin Neziri të gjithë nga Tetova, për veprën penale - bashkim kundër popullit dhe shtetit, neni 117, alineja 2, lidhur me nenin 100 dhe 101, alineja 1 nga LP. Aktakuza ishte ngritur edhe ndaj Agim Jakës e Ibrahim Rudit, që të dy nga Gjakova, po ashtu edhe këta i ngarkonte e njëjta aktakuzë.

Trupi gjykues ishte i përbërë nga gjykatësi Bogosav Nikodijeviç, kryetar i Këshillit, gjykatësit të rregullt Atanas Spasov, dhe gjykatësve porotë Kërste Mitrevski, Abdush Hysein dhe Maria Shundillova, procesmbajtës i procesit ishte Jordanka Nikanqeva. Të akuzuarit për t'i lehtësuar sadopak dënimet që do jepte Gjykata e Qarkut në Shkup, për mbrojtje kishin angazhuar avokatët më në zë. Kishin angazhuar dhe Gjorgji Petriqevski avokat nga Shkupi, Jovan Baroviq, avokat nga Beogradi, Sejdi Raufi, avokat nga Shkupi, Radmillo Millovanoviq, avokat nga Beogradi, Liljana Jakovleviq, avokate nga Beogradi, Abdullah Preshova, avokat nga Shkupi, Mirko Popov, avokat nga Shkupi, Mihajllo Gërbevski, avokat nga Shkupi, Sejdi Raufi, avokat nga Shkupi dhe Bogdan Bozhinovski, avokat nga Shkupi.

Më 25 qershor 1969, në Gjykatën e Qarkut në Shkup, para trupës gjykuese u ulën dhe iu dhanë dënimet e mëposhtme:

1. Memetriza Murtezani, me pseudonimin "Gega", kishte lindur më 19 nëntor 1921 në Tetovë, nga babai Ejup dhe nëna Hava e lindur Rustemi. Me profesion ishte axhustator dhe punonte në Fabrikën "Teteks" në Tetovë. Ishte i martuar dhe kishte një fëmijë. Kishte mbaruar shkollën për mësues por nuk kishte mundur të kryente punën e shenjtë të mësuesit ngaqë më 1955 ishte akuzuar dhe dënuar nga Gjykata e Qarkut në Gostivar për veprën penale nga neni 101 të LP prej 10 vitesh burg të rëndë. Për pjesëmarrje në demonstrata organet e ndjekjes e arrestuan dhe në burgun hetues ndodhej që nga 24 dhjetori i vitit 1968.

Në bazë të aktgjykimit me numër 129/69, Murtezani ngarkohej nga gjykata se kishte vepruar dhe organizuar shumë takime e mbledhje me të akuzuarit e tjerë, duke iu thënë se shqiptarët nuk gëzojnë asnjë të drejtë në RS të Maqedonisë dhe vazhdimisht kanë qenë të shtypur nga maqedonasit. Ndërsa, pjesa perëndimore e Maqedonisë dhe Kosova historikisht i kanë takuar Shqipërisë, argument i cili duhet t'i sqarohet çdo shqiptari. Ai ka propozuar se duhet të punohet me të madhe në zgjimin e vetëdijes kombëtare tek të gjithë shqiptarët, e sidomos tek mësuesit dhe hoxhallarët të cilët kanë mundësi që të bëjnë propagandimin e tyre; duhet përgatitur demonstrata masive popullore për t'ia bërë me dije qeverisë maqedonase për padrejtësitë e shumta që i bënë popullatës shqiptare dhe duhet treguar se Tetova, Gostivari, Dibra, Kërçova dhe Struga duhet të shkëputen dhe t'i bashkëngjiten Kosovës. Pas këtij bashkimi ajo duhet të shpallet Republikë e pavarur. E më vonë të gjitha tokat shqiptare t'i bashkëngjiten Shqipërisë.

Në bazë të aktakuzës dhe aktgjykimit, Gjykata e Qarkut në Shkup, në bazë të nenit 100 dhe 101 të LP. Memetriza Murtezanin e dënon me 7 (shtatë) vite burg të rëndë.

2. I akuzuari i dytë ishte Faik Mustafa, i lindur në Tetovë më 19 maj 1945, nga babai Shefki dhe nëna Sheqibe e lindur Rushani. Faiku në kohën kur u arrestua ishte student i rregullt në Fakultetin Filozofik në Prishtinë dhe njëkohësisht punonte si arsimtar në shkollën fillore të fshatit Sellce të Tetovës. Ishte i pamartuar dhe për vepra tjera penale nuk ishte i akuzuar. Në burgun hetues ndodhet që nga 24 dhjetori 1968.

Faik Mustafa ishte mik dhe shok i idealit dhe i përkiste grupit të Murtezanit, i cili me një dashuri të madhe përkrahu dhe u angazhua në grupin e organizatorëve të demonstratave në Tetovë. Po ashtu ishte mbështetës i kërkesave për shkëputjen e Maqedonisë Perëndimore dhe bashkimin e saj me Kosovën e pastaj me Shqipërinë. Edhe ky atdhetar akuzohej se kishte vepruar në përkrahje të programit të punës së grupit dhe akuzohej në bazë të nenit 100 dhe 101 të LP. Gjykatësi me 25 qershor 1969 i dha dënimin prej 5 (pesë) vitesh e 6 (gjashtë) muaj burg të rëndë.

Duke zbatuar platformën politike të paraqitur, si nën 1/1, nga fundi i vitit 1968, vihet në lidhje me të akuzuarit Agim Jaka dhe Ibrahim Rudi, të dy



nga Gjakova, dhe si i merr udhëzimet me shkrim afrohet me Abdyl Selam Selamin dhe Nexhbedin Nezirin, të dy nga Tetova. Që të gjithë angazhohen për të organizuar demonstrata për bashkimin e të gjitha tokave shqiptare nën ish Jugosllavi me Kosovën e më vonë do të pasonte bashkimi i Kosovës me Shqipërinë.

3. Abdyl Selam Selami, po ashtu kishte lindur në Tetovë më 27.08. 1939, nga babai Hajdar dhe nëna Safijee lindur Xhelaj. Me profesion ishte mësues dhe punonte në fshatin Veshallë të Tetovës. Në kohën kur u arrestua ishte i martuar dhe ende nuk kishin fëmijë. Ishte i padënuar deri më 27 dhjetor 1968, kur u arrestua nga organet e ndjekjes për pjesëmarrje në demonstrata.

Abdyl Selami kishte përkrahur idenë e shkëputjes së Maqedonisë Perëndimore dhe bashkimin e saj me Kosovën.

Për këtë arsye, Gjykata e Qarkut në Shkup kishte ngritur aktakuzën në bazë të nenit 100 dhe 101 të LP, duke i dhënë dënimin prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj burg të rëndë.

4. Ramadan Sinani, i quajtur ndryshe edhe "Ramush", kishte



# Tetovë më 22-23 dhjetor 1968




lindur më 16 korrik 1944 në Tetovë, nga babai Sinana dhe nëna Fatimee lindur Jonuzi. Ishte student i rregullt në Fakultetin Filologjik në Universitetin e Beogradit, dhe njëkohësisht punonte si arsimtar në shkollën fillore në Tetovë. Ishte i pa martuar. Deri më 27 dhjetor 1968, nuk ndiqej për ndonjë vepër penale.

Ramadani akuzohej se më 22 e 23 dhjetor 1968, në qytetin e Tetovës kishte organizuar demonstrata antishtetërore kundër jugosllave duke shkruar parulla antishtetërore, ka ngritur flamurin kombëtar në mes të sheshit, ka brohoritur para ndërtesës së organeve për punë të brendshme, ka kërkuar që të lirohen të burgosurit politik shqiptar etj.

Edhe pse kishte për mbrojtje avokat, gjykatësi i Qarkut në Shkup i dha dënimin prej 2 (dy) viteve burg të rëndë.

5. Fehmi Rufati, ishte nga Tetova dhe kishte lindur më 13 korrik 1947 nga babai Hajdar dhe nëna Besime e lindur Sinani. Ishte student i vitit të parë në Fakultetin Filologjik në Universitetin e Beogradit. Ishte i pamartuar në kohën kur u arrestua me 23 dhjetor 1968.

Edhe Fehmi Rufati akuzohej për veprën penale: Bashkim kundër popullit dhe shtetit, sipas nenit 117, alineja 1,në lidhje me nenin 100dhe 101 të Kodit Penal, dhe iu shqiptua dënimi prej 2 (dy) viteve burg të rëndë.

6. Abdyl Menaf Rustemi, ishte djalë i Mehmet Reshatit dhe i nënës Shehide. Ishte i lindur më 26 dhjetor 1946, në fshatin Tearrcë të Tetovës. Me profesion ishte mësues në fshatin e lindjes dhe student me korrespodencë në SHLP të Shkupit. Ishte i pamartuar. U arrestua më 23 janar 1969.

Më 25 qershor 1969, Gjykata e Qarkut në Shkup, edhe Rustemit i dha dënimin në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve burg të rëndë me akuzën për bashkim për të vepruar kundër shtetit dhe popullit.

7. Hisni Qemal Sherifi, lindi më 5 shkurt 1943, në fshatin Shipkovicë të Tetovës. Babai i tij quhej Sherif dhe nëna Mazllamshahe e lindur Demirlija. Në kohën kur u arrestua më 23 janar 1969, me vendbanim ishte në Tetovë. Me profesion ishte arsimtar në shkollën fillore të fshatit Tearrcë. Ishte i pamartuar dhe i padënuar penalisht deri kur u arrestua më 24 dhjetor 1968.

Sherifit iu dha një dënim më i vogël në krahasim me shokët, por jo më i lehtë, ngaqë burgu nuk matej me kohëzgjatje, por me dhunën që përdorej ndaj të burgosurit. Shpesh ndodhte që njerëzit-atdhetarët edhe sa ishin në hetuesi, nuk arrinin të dilnin fare të gjallë nga aty. Gjykata e Qarkut, në Shkup i dha dënimin prej 1 (një) viti burg të rëndë.

8. Refik Murati, lindi në fshatin Shipkovicë të Tetovës, më 25 dhjetor 1935, nga babai Shefki dhe nëna Rudije e lindur Elmazi. Me vendbanim të përhershëm ishte në Tetovë. Me profesion ishte murator. Është i martuar dhe baba i një fëmije. Kishte mbaruar shkollën fillore. Deri më tani nuk është i ndjekur penalisht. Më 23 dhjetor 1968 arrestohet dhe tani ndodhet në burgun hetues të Shkupit.

Për pjesëmarrje në demonstrata dhe për aktivitet antishtetëror iu dha dënimi prej 2 (dy) vitesh burg të rëndë.

9. Nexhbedin Neziri, ishte i dënuari i nëntë i këtij procesi. Lindi në fshatin Shipkovicë të Tetovës më 25 dhjetor 1935 nga babai Beqir dhe nëna Salije e lindur Selami. Tani jeton në Tetovë. Me profesion është mësues dhe në kohën kur u arrestua kishte postin e drejtorit të shkollës në fshatin Shipkovicë. Ishte i martuar dhe baba i katër fëmijëve. U arrestua më 20 shkurt 1969.

Sipas aktgjykimit me nr. 129 69, Nezirit iu dha dënimi prej 1(një) viti e 6 (gjashtë) muaj burg të rëndë.

10. Agim Jaka, kishte lindur në Gjakovë më 19 shkurt 1946, nga babai Xheladin dhe nëna Sanije e lindur Emra. Ishte student i vitit të tretë të Fakultetit Filozofik në Prishtinë. Ishte i pamartuar. Organet e ndjekjes e arrestuan më 24 janar 1969.

Agim Jaka dhe Ibrahim Rudi, nga fundi i vitit 1968 kanë rënë në kontakt me Faik Mustafën me qëllim që ta ndihmonin për organizimin e demonstratave. Në këtë periudhë ata kanë këmbyer letra se si duhet vepruar për të shkatërruar sistemin e instaluar prej okupuesi.

Gjykata e Qarkut në Shkup, më 25 qershor 1969, i jep dënimin prej 2 (dy) vitesh e 6 (gjashtë) muaj burg të rëndë, duke e akuzuar në bazë të nenit 117 alineja 1 të Ligjit Penal.

11. Ibrahim Rudi, ishte anëtari i fundit i grupit të Tetovës që akuzohej për pjesëmarrje në demonstrata të vitit 1968. Ai kishte lindur në Gjakovë më 6 dhjetor 1946, nga babai Abdylrahim dhe nëna Hidije e lindur Shita. Në kohën kur u arrestua ishte student i rregullt i vitit të dytë në SHLP në Prishtinë. Ishte i pamartuar, dhe më parë nuk ishte dënuar. Organet e ndjekjes e arrestuan më 7 mars 1969.

Edhe Ibrahim Rudin, Gjykata e Qarkut në Shkup e kishte dënuar me 3 (tri) vite burg të rëndë, duke e ngarkuar se kishte marrë pjesë në demonstratat gjithëpopullore që binin ndesh me kushtetutën dhe ligjet në fuqi.

Lirohen nga aktakuza:

1. Xhemil Mustafa, i lindur më 12 prill 1946, në Tetovë nga babai Shefki dhe nëna Sheqibe, e lindur Rushani. Mustafa në kohën kur u arrestua ishte student i vitit IV, pranë Fakultetit Filozofik të Universitetit të Beogradit. Ishte i pamartuar. Më parë nuk kishte qenë i dënuar. Më 30 janar 1969, organet e ndjekjes e arrestojnë dhe nga kjo datë ndodhej në burgun hetues të Shkupit. Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Shkup Mustafa lirohet nga aktakuza.

2. Agim Xhaferi, i lindur më 12 qershor të vitit 1946 në Tetovë, nga babai Husein dhe nëna Sehare e lindur Osmani. Në kohën kur u arrestua ishte student i rregullt në Fakultetin Juridik në Prishtinë. Gjer në kohën kur u arrestua (26 mars 1969), nuk ishte i ndjekur penalisht. Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Shkupit, më 25 qershor 1969, lirohet nga aktakuza.

3. Arben Xhaferi, i lindur në Tetovë më 24 janar 1948 nga babai Husein dhe nëna Sehare e lindur Osmani. Ishte student i vitit të dytë pranë Fakultetit Filozofik, në Universitetin e Beogradit. Ishte i pamartuar dhe shërbimin ushtarak të pakryer. Më parë nuk kishte qenë i dënuar. U arrestua më 26 mars 1969. Në procesin gjyqësor të Gjykatës së Qarkut në Shkup, më 1969, u lirua nga aktakuza.

4. Husein Xhevat Huseini, i quajtur "Kalishta", lindur në Tetovë më 15 maj 1945, nga babai Hilmi dhe nëna Havda, lindur Memurllai. Në kohën kur u arrestua ishte arsimtar dhe student me korrespodencë në vitin III të Fakultetit Filozofik në Shkup. Ishte i pamartuar dhe i padënuar deri më 30 janar 1969, kur e arrestuan organet e ndjekjes të Maqedonisë. Në procesin gjyqësor të grupit të organizatorëve të demonstratave të Tetovës, gjykatësi i Gjykatës së Qarkut të Shkupit e liroi nga aktakuza.

| | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
|  | | | | | | Autor: GAZMEND MORINA | KALORËS JAPONEZ (shq.) | KËNGËTARE E VJETËR SHQIPTARE | LLOJ ZOGU | BABAI | BARAZIM NË SHAH | I PESHOVA (bised.) | DJALLËZOR | ZANORE | EPOKA E RE | “EPOKA . ..” | SHTET NË AMERIKË |
| | | | | | | LËNDË E BARDHË NË TRAJTË KRISTALESH, ME SHIJE SHUMË TË ËMBËL | | | | | | | | | ESTONIA, NORVEGJIA / DHOMA KU MBAJNË MËSIM NXËNËSIT | | |
| | | | | | | MALLKIMI DHE PËRJASHTIMI NGA KISHA | | | | | | | | KANDËRR E VOGËL DHE E ZEZË QË BREN DRURIN E ORENDITË | | | |
| | | | | | | I SHKALLËS MË TË ULËT A I CAKUT MË TË POSHTËM | | | | | | | | NJËSIA MONETARE BAZË E SHQIPËRI (pashq.) / BASHKËT. | | | |
| | | | | | | URANIUM, TANTAL | | | | I THAVA | | | | | | ZANORE / GRADIM | |
| | | | | | | RRALLË (Lat.) / GJAKATARI | | | | “ZATESA” / BASHKËT. | | | | SEARCH AND RESCUE / SHKOP I BILARDOS | | | |
| | | | | | | → | | | | | | KRYEQYTETI I KANADASË / QYTET NË SHQIPËRI | | | | | |
| | | | | | | ISH FUTBOLLISTI I ÇEKISË ... KOLLER | | | | KËNGËTARJA ZYMERI / DY BASHKË-TINGËLLORE | | | | | AZEM GALICA / FRIKË NGA AJRI | | |
| EPOKA E RE | KËNGËTARJA AMERIKANE NË FOTO (shqip.) | LLOJ GËLQERORI | BIMË BARISHTORE NJËVJEÇARE QË BËN KOKRRA TË THARA | SHKRONJA GREKE | VITI I RI KINEZ | I ZË ME DORË / EMËR FEMRE MYSLIMANE | | | | | SHKRONJA XVI / OWN KING'S INSTITUTE | | FUTBOLLISTI NIGERIAN NWANKWO (ARSENAL, PORTSMOUTH) / ISMET PEJA | | | | |
| PJESË E SIPËRME KOSTUMIT, ME MËNGË E ME JAKË TË KTHYER | | | | | | | ELBASANI / HYJNIA E DASHURISË NË MITOLOGJINË ROMAKE | | KËNGËTARI WILLIAMS (shqip.) / MJET PËR TË RRËSHQITUR MBI BORË | | | | | SHKOVA, IKA (bised.) / 100 M$^2$ | | | |
| SKUQJA E LËKURËS NGA ZGJERIMI I KAPILARËVE | | | | | | | | BASHKËT. | | PARADHËNIA / QËLLUAR RASTËSISHT NË NJË NGJARJE | | | | | | | GURRË (sh.shq.) |
| GJYMTIM | | | | | | | | KËNGËTARI AMERIKAN .... BROWN (shqip.) / HUNDORËSI (ling.) | | | | | KRYEQYTETI I NJË SHTETI TË MADH EVROPIAN / QYTET NË ILIRI (pashq.) | | | | |
| “G” në mes të dy “I” | | | | QESËNDIA / PËREMËR PRONOR | | | | | | | KËNGËTARI .... VLADI / DY ZANORE | | | | | BASHKËT. / ARKIVI I FILMAVE | |
| MARRE | | | | | EPOKË (shq.) / THIRRJE QË I BËHET TURMËS (sh.shq.) | | | | KËNGËTARI .... MALAJ / OLIVIA MUNN | | | | | NJËSI PESHE (vjet.) / LLOJ PAPAGALLI | | | |
| SHPIRTI (Lat.) | -------------- | | | | | AI QË ZOTËRON NJË PASURI A DIÇKA TJETËR / ZEZAK, I ZI | | | | | | EMËR YNI MASHKULLI / MËSIMI PRAKTIK OSE TEORIK NË GRUPE | | | | | |
| SILIC, KALIUM | | | | PAMELA ANDERSON / USHTARAK (bised.) | | | PREZANTUESE E NJOHUR SHQIPTARE / “INDIANA” | | | | LLOJ HELMI LUFTE / FURRAT KU PIQEN TULLAT | | | | | | MBATHËSET SPORTIVE |
| ISMET TOTO | | | AKTORJA E FAMSHME ..... STRIP / TËRËSIA E LËVIZJEVE TË PJESËVE TË FYTYRËS | | | | | | PJESA E NGRITUR E TEATRIT KU LUAJNË AKTORËT | | | | | | OHAJO, PENSILVANIA / AKTORJA AMERIKANE ..... MILANO (shqip.) | | |
| BASHKËT. | | KLUB FUTBOLLI NË ITALI (shq.) / RADIUM, TON | | | | | | | UNIVERSITY ARKANSAS MONTICELLO / FUTBOLLISTI I NJOHUR PATRICE | | | | KËSTI BANKAR PËR KTHIMIN E KREDISË / DY BASHKË-TINGËLLORE | | | | |
| QYTET NË MAQEDONI (pashq.) | | | | | | | STACION (sh.shq.) / LLOJ GJELLE ME PATATE | | | | | | | | | | |
| KONFERENCË ME KARAKTER NDËRKOMB-ËTAR | | | | | | PLUGIN ELECTRIC VEHICLES / NJËSI E MATJES SË FUQISË SË RRYMËS | | | | BASHKIM QELIZASH TË NJËLLOJTA / GRIMCOVE (bised.) | | | | DY (turq.) / AKTORJA E VJETËR ... RINA | | | |
| PEZMATIM I VESHIT | | | | | DRITARJA E DYQANIT PËR TË VËNË MALLRA TË NDRYSHME / TITAN | | | | | | | | FUTBOLLISTI KUENKA (BARCELONA) / ERNEST KOLIQI | | | | |
| BASHKËT. | | SHTET NË AZI (pashq.) / BASHKËT. | | | | | | BISKOTA E GATUAR ME ARRA OSE ME BAJAME TË SHTYPURA / BASHKËT. | | | | | | | | ZANORE / KRUJA | |
| EPOKA E RE | VLERË E MONEDHËS SË NJË SENDI KUNDREJT ARIT | | | | | | | | SHKENCA QË STUDION MORALIN | | | | | | KASTRIOT TUSHA | | |

# Nga Instagram te PayPal, ja si Rusia po fiton luftën e informacionit



Raportet e Kongresit mbi ndërhyrjen zgjedhore ruse sinjalizojnë një zgjerim të mediave sociale të bombarduara me informacione false dhe propagandë në shënjestër

Renée Di Resta, kreu i një prej dy organizatave të sigurisë kibernetike që akuzohet nga Senati i SH.B.A.-së se analizon manipulimet ruse të informacionit që qarkullon në Net, e bën atë akoma më të vështirë: ai flet për luftën e informacionit dhe, në një editorial në New York Times, ai thotë se ka filluar një racë armësh që nuk mund të fitohet, pasi arsenalet janë vazhdimisht në zhvillim.

Por mund të arrihet të minimizohen dëmet nëse politikat, kompanitë digjitale dhe përdoruesit e kuptojnë rëndësinë e asaj që po ndodh, rreziqet për demokracinë dhe në të vërtetë bien dakord të bashkëpunojnë.

Por mund të arrihet të minimizohet dëmi nëse politikat, kompanitë digjitale dhe përdoruesit e kuptojnë rëndësinë e asaj që po ndodh, rreziqet për demokracinë dhe bien dakord të bashkëpunojnë.

Dy raportet e porositura nga një trup i Kongresit të udhëhequr nga republikanët (Komisioni i Inteligjencës i kryesuar nga senatori Richard Burr) dhe të botuar të hënën – atë të Njohurive të Reja, kompania DiResta që punoi me studiuesit e Universitetit të Kolumbias dhe një nga analistët e Universitetit të Oksfordit së bashku me një kompani tjetër të specializuar, Grafika – shkojnë shumë përtej konfirmimit zyrtar të ndërhyrjes së Kremlinit në zgjedhjet e vitit 2016: një fakt i mohuar gjithmonë (ose vënë në tallje) nga Donald Trump.

Dokumentet konvergojnë në përshkrimin e një tabloje edhe më alarmante, si për atë që ndodhi gjatë fushatës presidenciale, si për punën masive të dezinformimit që vazhdoi edhe më vonë, në 2017 dhe më tej, duke sulmuar hetuesit amerikanë (sidomos super prokurori Mueller dhe ish-kreu i FBI-së, Comey) dhe duke zgjeruar audiencën e shoqërive të bombarduara me informacione false dhe mesazhe në shënjestër të propagandës.

Deri më tani vëmendja u përqendrua në manipulimin e Facebook, YouTube dhe Tëitter. Anketa e dorëzuar në Kongres zbuloi se "falsifikuesit" e Agjencisë Kërkimore të Internetit (IRA), organizata e Shën Petersburgut zyrtarisht private, por të menaxhuar nga një sipërmarrës shumë afër Putinit, kanë përdorur gjithashtu të gjitha platformat e tjera digjitale, nga Snapchat në Tumblr, nga Pinterest në Reddit, për të përhapur lajme të rreme dhe mosmarrëveshje ushqimi.

Edhe mediat sociale më të vogla: kanë audienca më të kufizuara, por ato janë më të prekshme, pa kontrolle efektive të sigurisë. Manipuluesit rusë kanë përdorur edhe platforma të pagesave si PayPal për të organizuar marshime dhe protesta. Instagram, që deri më tani nuk është marrë në shqyrtim, del si mjet në të cilin IRA ka derdhur në mënyrë efektive mesazhet e saj shkatërruese, veçanërisht pasi Facebook dhe Twitter kanë rritur mbikëqyrjen në rrjetet e tyre.

Luftëtarët kibernetikë rusë nuk u kufizuan në favorizimin e Trump me mesazhe të mbështetjes drejtuar votuesve të tij të mundshëm ose duke denigruar Hillary Clinton. Ata gjithashtu u përpoqën t'i mbajnë zezakët – kryesisht demokratë – larg nga sondazhet me mesazhe që synojnë të shkaktojnë pakënaqësi dhe t'u japin informacion të gabuar sesi të votojnë. Gjëja është politikisht e rëndësishme sepse, siç vërehet nga Naacp, liga kryesore e të drejtave civile për njerëzit e zinj (e cila gjithashtu promovoi një javë bojkotimi të Facebook), në vitin 2016 numri i votuesve afrikano-amerikan ra për herë të parë për 40 vjet. Faji i këtyre manovrave të fshehura ose i mungesës së apelit të Hillarit? Sigurisht, Clinton do të ishte presidenti sot nëse në Michigan, Pennsylvania dhe Wisconsin nuk do të ishte mbajtur elektorati i zi në epokën e Obamës.

Megjithatë, IRA ka vazhduar të ushqejë mosmarrëveshjen racore edhe pas zgjedhjeve presidenciale dhe tani është duke synuar hispanikët, duke kërkuar të shtojë grindjet rreth emigrantëve të paligjshëm.

Kuptohet me vonesë të madhe se çfarë po ndodhte dhe pasi minimizoi krizën, Facebook, Google dhe Twitter kishin premtuar të konkurrojnë për t'u mbuluar. Pjesërisht ata e bënë, por boshllëqet në njërën anë janë rihapur diku tjetër.

Dhe kompanitë e akuzuara nga Kongresi për të monitoruar situatën akuzojnë gjigantët e teknologjisë së fshehjes: ata ofruan analistë me të dhëna të pjesshme, shpesh të pakuptueshme, pasi ishin jashtë kontekstit. Dhe, në çdo rast, të dhënat e mëdha kanë ardhur vetëm nga SHBA, ndërsa për Times ka gjurmë të ndërhyrjeve të rënda edhe në Itali, Britani e Madhe dhe Brazil dhe analistët janë të sigurt për sulmet ruse gjatë referendumeve të ndryshme, nga Spanja në Maqedoni.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com
Montimi
Servisim
Porosi

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| BRIGHTON - ARSENAL | 2 | LEICESTER - MAN CITY | 2 | TOTTENHAM - BOURNEMOUTH | 1 |

# Zaberxha refuzon Llapin dhe Vëllaznimin

Ish-sulmuesi i Hysit, Enis Zaberxha, ende nuk ka vendosur se ku do të luajë në pranverë. Ai për "Epokën e re" ka bërë me dije se ka refuzuar dy skuadra të IPKO Superligës dhe një skuadër të Ligës së Parë. "Kam pasur oferta nga Llapi dhe Vëllanzimi i Gjakovës si dhe nga KEK-u, por dy të parat i kam refuzuar për shkak të largësisë. Vendi i punës po me penalizon për ta zgjedhur ofertën më të mirë", ka thënë Zaberxha



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

**Prishtinë, 25 dhjetor** - Futbollisti Enis Zaberxha është një nga sulmuesit më të mirë në futbollin e pasluftës. Pavarësisht se vitet po ecin, interesimi i klubeve nga rangu elitar dhe ai i Ligës së Parë për sulmuesin këmbëshpejtë mbetet i pandryshuar. Zaberxha në gjashtë muajit e kaluar ka luajtur për skuadrën e Trepçës, kurse tash ende nuk ka vendosur se ku do ta vazhdojë karrierën. Ai të martën për "Epokën e re" ka thënë se fillimisht do të bisedojë me klubin nga Mitrovica dhe më pas të vendosë për të ardhmen. "Kam pasur kontratë vetëm për gjashtë muaj me Trepçën dhe tash jam lojtar i lirë. Fillimisht do të bisedoj me kryesinë e kësaj skuadre për ta parë ofertën dhe ambiciet e tyre për pranverë e më pas do të vendos për të ardhmen", ka deklaruar Zaberxha.

Pas përfundimit të sezonit vjeshtor, Zaberxha është kontaktuar nga tri klube, dy të IPKO Superligës dhe një nga Liga e Parë. Ai ka nuk ka hezituar t'i tregojë edhe emrat e këtyre skuadrave dhe arsyen pse i ka refuzuar. "Kam pasur oferta nga Llapi dhe Vëllanzimi i Gjakovës si dhe nga KEK-u, por dy të parat i kam refuzuar për shkak të largësisë. Vendi i punës po me penalizon për ta zgjedhur ofertën më të mirë", ka thënë Zaberxha.

Skuadra e Trepçës e mbylli sezonin vjeshtor në pozitën e shtatë me 24 pikë, shtatë pikë më pak se skuadrat që pozicionohen në vendet që luajnë në barazh. Lidhur me rikthimin e mundshëm në Superligë të Trepçës, Zaberxha ka deklaruar: "Me këtë fond të futbollistëve nuk mund të luftojë as për pozitat që dërgojnë në barazh, por nëse përforcohet me katër ose pesë futbollistë do të bëjë një gjë të tillë pa asnjë problem, pse jo edhe të rikthehet në Superligë".

Enis Zaberxha gjatë karrierës së pasur futbollistike ka luajtur për Hysin, Llapin, KEK-un, Trepçën dhe Drenicën.

## SHKURT

### Berisha, lojtari më i mirë i xhiros së dytë në FIBA Europe Cup

Dardan Berisha e ka marrë një lajm të shkëlqyeshëm nga FIBA. Ylli i basketbollit në Kosovë është zgjedhur lojtari më i mirë i xhiros së dytë të fazës së dytë të grupeve në FIBA Europe Cup. Basketbollisti i Z Mobile Prishtinës ka realizuar 17 pikë dhe gjashtë asistime, ndërsa fitoi 58 % të votave të tifozëve, duke i lënë pas vetes katër basketbollistë rivalë të klubeve të tjera.

### Lamçja largohet nga Drita

Eri Lamçja nuk do të jetë pjesë e skuadrës së Dritës në sezonin pranveror, pasi skuadra kampione e Kosovës ka njoftuar se me marrëveshje të dyanshme është ndërprerë bashkëpunimi me sulmuesin nga Shqipëria. "Është arritur marrëveshja për shkëputjen e bashkëpunimit në mes të sulmuesit nga Shqipëria, Eri Lamçja dhe klubit tonë. Lamçja nuk arriti të ambientohet sa duhet me klubin dhe me marrëveshje të dyanshme janë ndarë rrugët. FC Drita e falënderon Erin për kontributin e dhënë dhe i dëshiron suksese në karrierë", thuhet në njoftimin e Dritës.

### Sahiti rikthehet në Vëllaznim

KF Vëllaznimi e ka rikthyer futbollistin Samir Sahiti, i cili në të kaluarën me plot sukses i kishte mbrojtur ngjyrat kuqezi. Lajmin për rikthim në këtë klub e ka konfirmuar vetë futbollisti nga Mitrovica nëpërmjet një postimi në "Facebook". "Nga sot jam lojtar i KF Vëllaznimi. Faleminderit presidentit Agim Cana, faleminderit trajnerit Ismet Munishi! Vazhdojmë fuqishëm!", ka shkruar Sahiti.

### Trajneri i Lokomotivës ngre në qiell futbollistët shqiptarë

Goran Tomiç, trajner aktual i Lokomotivës së Zagrebit, ka thurur lavde për dy futbollistët shqiptarë, Myrto Uzuni dhe Lirim Kastrati, që luajnë në Kroaci. Gjatë analizës që ai ka bërë për sezonin që ekipi i tij ka zhvilluar, trajneri kroat u shpreh i lumtur për paraqitjet që futbollistët e tij kanë dhënë dhe është shprehur i impresionuar nga dyshja shqiptare. "Jam shumë i impresionuar me lojtarët e rinj. Kastrati dhe Uzuni kanë kaluar çdo pritshmëri të timen. Gjithsesi, nuk është koha për eufori, por duhet të vazhdojmë me këto ritme", ka përfunduar 41-vjeçari.

## "Telashe" për Mavrajn dhe Cikalleshin

**Tiranë, 25 dhjetor** - Lojtarët e kombëtares shqiptare nuk po kalojnë një periudhë të mirë në këtë fund viti. Pas Mërgim Mavraj i cili po gjen vështirësi në Greqi me skuadrën e "Arisit", edhe Sokol Cikalleshi me shumë gjasa do të largohet nga klubi i tij në muajin janar. Sipas medieve turke "Fanatik", klubi i Goztepes do të largojë sulmuesin kavajas bashkë me shokun e tij të skuadrës, Gufran pasi sipas trajnerit, asnjëri prej tyre nuk ka arritur të përmbushë pritjet për të qenë pjesë e klubit. Karriera e Sokol Cikalleshit nuk ka pasur ritme pozitive vitet e fundit. Pasi ka humbur vendin e tij në kombëtaren që drejtohet nga Christian Panucci, ai duhet të gjejë një skuadër para mbylljes së afatit kalimtar dimëror.

## Liverpooli dominon 11-shen më të mirë në Premierë Ligë




LONDËR, 25 DHJETOR - Derisa Premierë Liga po hyn në një fazë shumë të ngjeshur të ndeshjeve të fundvitit, "Goal" ka bërë përzgjedhjen e 11 lojtarëve me formën më të lartë deri tani në këtë sezon. Sipas "Goal"-it, ekipin e 11 më të mirëve e dominon lideri, Liverpooli, me katër futbollistë, kurse nga dy kanë City, Arsenali e Chelsea. E vetëm një lojtar në këtë ekip yjesh e ka Tottenhami. Ekipi më i mirë i pjesës së parë të këtij sezoni në Premierë Ligë është i kësaj përbërje: Alisson, Robertson, Laporte, Van Dijk, Azpilicueta; Torrerira, Aubameyang, Salah, Sterling, Hazard, Kane.

# LeBron: Gjithmonë kam rekrutuar lojtarë për ekipin tim




LOS ANGELES, 25 DHJETOR - LeBron James vuri në dukje se gjithmonë rekruton lojtarët e ekipeve të tjera dhe se kjo është një gjë krejtësisht normale. Basketbollisti zbuloi këtë duke vënë në dukje se si një lojtar i Los Angeles Lakersit do të përpiqet të sjellë një yll të ri në Staples Center. Në fakt, mediet amerikane kanë shkruar ditë më parë se Carmelo Anthony mund të jetë lojtar i ri i Lakersave. "Unë gjithmonë kam rekrutuar lojtarë, nuk e di nëse kjo është diçka e re. Kam provuar gjithmonë të sjell lojtarë që nga viti 2007. Ata shpesh më kanë refuzuar, por kam sjellë shumë. Shumë basketbollistë nuk dëshironin të vinin në Cleveland Cavaliers, por nuk ishte e vështirë t'i sjell djemtë në Miami. Mendoj se nuk do të jetë e vështirë edhe tani në L.A. Por, ne duhet të fitojmë dhe, në fund të ditës, gjithçka do të rregullohet", ka thënë James. Në ditët e fundit lakersat raportohet se po interesohen për Anthony Davisin dhe Jamesi është parë nga shumë si "karrem" kryesor për ardhjen e "Rev". Ndryshe, lakersat nuk e kanë nisur mirë sezonin e ri në NBA, ku deri më tani kanë bilanc prej 19 fitoreve dhe 14 humbjeve.

# Coldwell: Wilderi e ka më lehtë ta mposhtë Joshuan se Furyn




LOS ANGELES, 25 DHJETOR - Trajneri i boksit, Dave Coldwell, beson se Deontay Wilder do ta ketë më të lehtë ta mposhtë Anthony Joshuan sesa ta fitojë rimeçin kundër Tyson Furyt. Britaniku Joshua i mban titujt IBF, WBO dhe WBA, ndërsa Wilder arriti ta mbrojë titullin WBC në meçin kundër Tyson Furyt, i cili u zhvillua në fillim të këtij muaji dhe përfundoi baras. Ndërsa Wilderi e mbrojti titullin kampion bote në kategorinë e rëndë divizioni WBC pas meçit ndaj Tyson Furyt, i cili mbaroi me barazim në Staples Centre të Los Angeles të dielën në mëngjes. Një nokaut në rundin e fundit, 12, doli të jetë vendimtar që lufta të shpallej e barabartë, me britanikun Fury që po udhëhiqte me pikë deri në atë çast. Fury dhe Wilderi e dëshironin rimeçin dhe e morën autorizimin për këtë gjë nga WBC-ja dhe kjo mund ta shtyjë meçin mes Joshuas dhe Wilderit edhe më shumë. "Kur e shikon Wilderin, duhet të mendosh se ai do të jetë më i mirë në meçin e ardhshëm, ndërsa Fury duhet ta pyesësh veten nëse mund të bëhet më i mirë se kaq? Jo, sepse cilido boksier mund ta mposhtë atë, mjafton që t'i durosh goditjet e tij", ka thënë Coldwell. "Wilderi mund ta shikojë këtë situatë dhe të mendoj se mund të ndeshet me Joshuan për një shumë të madhe parash. Dhe pasi që Joshua është më tradicional, ndoshta më i lehtë për ta goditur, ai është opsioni më i lehtë. Ai mund të thotë: 'Në rregull, le të shkojmë ta mposhtim Joshuan, t'i marrin paratë dhe mundësinë e tij për t'u shpallur kampion i unifikuar i boksit dhe pastaj të shkojmë te Tyson Fury. Por, mendoj se ata e duan rimeçin menjëherë për shkak të krenarisë që e kanë boksierët dhe njerëzve që u thonë se duhet ta mposhtësh atë njeri. Por, mendoj se nga një këndvështrim biznesi, ka më shumë kuptim për Wilderin të ndeshet me Joshuan sepse është opsioni më i lehtë dhe bëhet fjalë për shumë para", ka deklaruar Coldwell.

## SHKURT

### 39-vjeçari Rossi: Titulli i 10 nuk është limiti i karrierës sime

Piloti italian Valentino Rossi ka deklaruar se nuk ka një limit për sa i përket së ardhmes së tij dhe se mund të vazhdojë të pilotojë në Moto GP edhe pas vitit 2020, kur përfundon kontrata e tij me motorin Yamaha. "Titulli i 10 kampion apo mosha ime 39 vjeçe është thjesht shifër, që nuk ka asnjë rëndësi. Unë do të vazhdoj të pilotoj një motor edhe pasi ta fitoj titullin e 10 kampion. Ashtu siç kam thënë gjithnjë, vazhdoj të garoj pasi argëtohem në pistë dhe për të fituar gjithnjë. Nëse do të mbërrij titulli i 10 do të jem dyfish i lumtur, nëse jo do të garoj për ta argëtuar veten dhe fansat", ka thënë Rossi. "Unë kam një kontratë deri në vitin 2020, por nuk kam vendosur ende se çfarë do të bëj pas këtij viti. Ndoshta nuk do të jetë sezoni im i fundit. Kjo është një gjë për të cilën do të reflektoj kur të jetë koha. Unë punoj për të qenë kompetitiv gjithnjë në pistë, për të fituar dhe argëtuar fansat. Ndaj mezi po pres testet dimërore për të parë se deri ku mund të shkoj këtë sezon", ka shtuar Rossi.

### Juve e sheh Lukakun pasardhës te Mandzukiqit

Mario Mandzukiq është "lideri i heshtur" i Juventusit, pasi ylli kroat luan ku do trajneri, sakrifikon shumë dhe, siç ka treguar në vitet e fundit, shënon gjithnjë e më shpesh gola me peshë për bardhezinjtë, ashtu siç ka bërë në këtë sezon ndaj Interit e Romës. Por në fund të këtij sezoni kroati do të jetë 33-vjeçar dhe drejtuesit e klubit bardhezi kanë filluar që tani të mendojnë për ta gjetur zëvendësuesin e tij dhe për këtë kanë hedhur sytë nga kampionati anglez. Mediet britanike kanë raportuar se klubi italian e ka pikëtuar sulmuesin belg të Manchester Unitedit, Romelu Lukaku, si zëvendësim për Mandzukiqin.

### Milani apelon në CAS

Beteja ligjore mes Milanit dhe UEFA-s nuk ka përfunduar. Klubi kuqezi ka vendosur të apelojë në Gjykatën e Arbitrazhit sportiv vendimin e qeverisë së futbollit evropian për mosrespektimin e "fair-play"-it financiar, ndërkohë që kërkoi edhe një ridiskutim të termave për të qenë sërish brenda këtij rregulli. Në një komunikatë për shtyp, Milani shfaqi kundërshtimin e tij për vendimin e dhënë kundër tij duke konfirmuar edhe vendimin e tij për CAS. Përpara pak kohe UEFA vendosi ta gjobisë Milanin me 12 milionë euro, ndërkohë që i kërkoi me detyrim barazimin e bilancit financiar deri në vitin 2021, në rast të kundërt kuqezinjtë do të përjashtohen nga kompeticionet evropiane, pa harruar këtu edhe kufizimin në 21 të numrit të futbollistëve që do të regjistrohen.

### Cavani paguhet 13 milionë euro në vit, por është futbollisti më modest

Pjesa më e madhe e futbollistëve janë të rrethuar gjatë gjithë kohës nga luksi, teksa preferojnë të bëjnë shpenzime të shumta, por kjo gjë nuk vlen për Edison Cavanin. Sulmuesi i PSG-së nuk është futbollist i zakonshëm, këtë gjë e ka dëshmuar edhe gjatë një vizite në vendlindjen e tij, Salto, ku është shfaqur si çdo uruguaian tjetër. Cavani është parë i veshur si çdo banor tjetër i Saltos dhe duke e përdorur transportin publik rrugës për në Montevideo, për t'iu bashkuar shokëve në ekipin kombëtar. Edhe pse 31-vjeçari paguhet plot 13 milionë euro në vit, paraja për të nuk është gjithçka, teksa ai dhe familja e tij kanë hequr dorë nga luksi duke jetuar njësoj si banorët e tjerë të Uruguait.

BQK

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

**Titulli:** **Auditor i TI-së**

**Departamenti: i Auditimit të Brendshëm**

**Niveli i gradës: 5**

**I raporton: Drejtorit të Departamentit të Auditimit të Brendshëm**

**Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësive:**

- Kryen angazhime të auditimit dhe të tjera përkatëse në përputhje me kornizën e përgjithshme ligjore të aplikueshme në BQK, atyre të auditimit të brendshëm në veçanti, përfshirë Standardet Ndërkombëtare dhe Praktikat profesionale te auditimit në përgjithësi;
- Zhvillon dhe ekzekuton planin vjetor të auditimit të TI-së si pjesë e planit të përgjithshëm të auditimit të brendshëm;
- Planifikon proceset e auditimit të TI-së përmes së cilave vlerësohen kontrollet e brendshme dhe performanca, në pajtueshmëri me standardet profesionale;
- Kryen auditime të: kontrolleve të përgjithshme të TI-së; të kontrolleve të aplikacioneve; të qeverisjes në TI; të vazhdimësisë së biznesit dhe rikthimit nga fatkeqësia; të sistemit për menaxhim të sigurisë së informacionit, dhe auditime të tjera të kërkuara;
- Përgatit dhe ekzekuton programe auditimi për të kryer auditime të TI-së duke përcaktuar objektivat e auditimit, kriteret e auditimit dhe duke identifikuar rreziqet dhe kontrollet;
- Dizajnon procedura testimi me qëllim të vlerësimit të adekuatshmërisë së kontrolleve të TI-së për përmbushje të objektivave të auditimit;
- Siguron, analizon dhe vlerëson të dhënat mbështetëse (evidencat) përmes veglave të ndryshme ndihmëse;
- Përgatit raportet e auditimit nën mbikëqyrje minimale të tilla që pasqyrojnë qartë objektivat e auditimit, fushëveprimin, gjetjet, rekomandimet, dhe konkluzionet;
- Përcjell zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimet e mëhershme të TI-së;
- Përgatit raportet javore, tremujore dhe vjetore lidhur me auditimet e TI-së, si dhe raportet tjera me kërkesën e Drejtoreshës së Departamentit të Auditimit të Brendshëm apo Shefit të Auditimit të Brendshëm;
- Kryen auditime të pa planifikuara sipas Statutit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- Kryen detyra të tjera me kërkesë të Menaxhmentit të Auditimit të Brendshëm, si dhe në rast nevoje e ndihmon atë në aktivitete të ndryshme të kërkuara.

**Kualifikimet e kërkuara:**

- Diplomë universitare në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike, Elektroteknike apo Shkenca Matematikore;
- Çertifikim profesional në fushat e auditimit të TI-së; të TI-së ose auditimit të brendshëm do të jetë përparësi.

**Përvoja dhe njohuritë e kërkuara:**

- Se paku 3 vjet përvojë pune në fushën e TI-së, përvojë pune në auditim do të jetë përparësi;
- Njohuri në fusha të ndryshme të teknologjisë: si zhvillim softueri; sisteme operative; menaxhim i data bazës; dhe rrjeta;
- Njohja e Standardeve të auditimit të brendshëm (nga IIA);
- Njohja e kornizave dhe standardeve si COBIT, ISO 27001, ITIL, etj.;
- Njohja e veglave për mbledhjen, analizën dhe përpunimin e të dhënave (Excel, IDEA, etj.) dhe
- Njohuri të tjera përkatëse do të jenë përparësi.

**Kërkesat e posaçme:**

- Të mbaj nivel të lartë të besueshmërisë në pajtim me politikat e punësimit, kodin e etikës dhe statutin e auditorit të brendshëm;
- Aftësi të duhura të krijimit dhe përdorimit të letrave të punës dhe dëshmive të tjera;
- Aftësi për komunikim në të shkruar dhe në të folur dhe aftësi për prezantim;
- Aftësi për të menaxhuar dhe motivuar punën në ekip me kolegët tjerë të auditimit;
- Aftësi për zgjedhje të detyrave komplekse pa mbikëqyrje;
- Preferohet njohja e gjuhës angleze.

**Të gjithë kandidatët duhet t'i dërgojnë dokumentet e nevojshme:**

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga organizata kompetente;
- Kopjet e diplomave, diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura/ nostrifikuara zyrtarisht nga MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

- **Procedura e aplikimit:**
- Afati i fundit për aplikim është **09 janar 2019**.
- Aplikimi mund të bëhet on line (https://hris.bqk-kos.org) ose përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së, nr.22. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare www.bqk-kos.org
- **Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.**

BQK

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## KONKURS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

**Naziv radnog mesta: Revizor IT-a**

**Departman : Departman unutrašnje revizije**

**Stepen radnog mesta: 5**

**Izveštava: Direktoru Departmana za unutrašnju reviziju**

**Pregled dužnosti i odgovornosti:**

- Obavlja poslove revizije i druge relevantne poslove u skladu sa opštim primenljivim pravnim okvirom CBK-a, posebno onim unutrašnje revizije, uključujući Međunarodne standarde i profesionalne prakse revizije uopšte;
- Razvija i sprovodi godišnji plan revizije IT-a kao deo opšteg plana unutrašnje revizije;
- Planira procese revizije IT-a putem kojih se procenjuju unutrašnje kontrole i učinak, u skladu sa profesionalnim standardima;
- Vrši reviziju opštih kontrola IT-a; kontrola aplikacija; upravljanja IT; kontinuiteta poslovanja i povratka sa nesreće; sistema za upravljanje bezbednosti informacije, i druge potrebne revizije;
- Priprema i sprovodi programe revizije za izvršenje revizija IT-a definisanjem ciljeva revizije, kriterijuma revizije i identifikovanjem rizika i kontrola;
- Dizajnira procedure testiranja u cilju procene adekvatnosti kontrola IT-a o ispunjavanju ciljeva revizije;
- Obezbeđuje, analizira i procenjuje prateće podatke (zapise) putem različitih pomoćnih alata;
- Priprema izveštaje revizije pod minimalnim nadzorom koji jasno odražavaju ciljeve revizije, delokrug, nalaze, preporuke i zaključke;
- Prati sprovođenje preporuka datih u ranijim revizijama IT-a;
- Priprema sedmične, kvartalne i godišnje izveštaje vezanih za revizije IT-a, i druge izveštaje na zahtev direktorke Departmana za unutrašnju reviziju ili šefa za unutrašnju reviziju;
- Obavlja neplanirane revizije u skladu sa Statutom unutrašnje revizije; i
- Obavlja druge poslove na zahtev rukovodstva unutrašnje revizije, kao i, ako je potrebno, pomaže u različitim potrebnim aktivnostima.

**Potrebne kvalifikacije:**

- Univerzitetska diploma sa Fakulteta računarskih, elektronskih ili matematičkih nauka;
- Profesionalna sertifikacija u oblastima revizije IT-a; IT-a ili unutrašnje revizije biće prednost.

**Potrebno iskustvo i znanje:**

- Najmanje 3 godine radnog iskustva u oblasti IT-a, radno iskustvo u reviziji biće prednost;
- Znanja u različitim oblastima tehnologije kao što su: razvoj softvera; operativni sistemi; upravljanje bazama podataka; i mreže;
- Poznavanje standarda unutrašnje revizije (od IIA);
- Poznavanje okvira i standarda kao što su: COBIT, ISO 27001, ITIL, itd.;
- Poznavanje uređaja za prikupljanje, analizu i obradu podataka (Excel, IDEA, itd.) i
- Druga relevantna znanja biće prednost.

**Posebni zahtevi:**

- Održati visok nivo kredibiliteta u skladu sa politikama zapošljavanja, etičkim kodeksom i statutom unutrašnjeg revizora;
- Odgovarajuće veštine stvaranja i korišćenja radnih dokumenata i drugih dokaza;
- Veštine u pisanoj i verbalnoj komunikaciji i veštine prezentacije;
- Sposobnost upravljanja i motivacije grupnog rada sa drugim kolegama revizije;
- Sposobnost za rešavanje složenih zadataka bez nadzora;
- Poželjno je poznavanje engleskog jezika.

**Svi kandidati treba da podnesu sledeće dokumente:**

- Zvanični obrazac CBK-a za apliciranje;
- Propratno pismo u kojem se naglašava interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu koju izdaje nadležna organizacija;
- Kopije diploma, diplome koje su stečene van Republike Kosovo treba da budu zvanično priznate/ potvrđene od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu i stalnom mestu boravka na Kosovu.

- **Procedura apliciranja:**
- Rok za apliciranje je **09. januar 2019. godine**;
- Apliciranje se može vršiti putem interneta (https://hris.bqk-kos.org) ili putem zvaničnog veb-sajta CBK ili preko CBK arhive, br. 22. Nijedan drugi oblik apliciranja neće biti uzet u obzir;
- Obrazac za apliciranje možete preuzeti na zvaničnom veb-sajtu: www .bqk-kos.org;
- **Nepotpuna dokumentacija neće biti razmatrana.**

BQK

**BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**
**CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO**
**CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO**

## SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

**Titulli:** **Zyrtar i Ri për Logjistikë**

**Divizioni:** **Divizioni i shërbimeve administrative dhe transportit**

**Grada:** 7

**I raporton:** **Udhëheqësit të Divizionit**

**Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësive:**

- Planifikon, implementon dhe kontrollon në mënyrë efikase dhe sa më ekonomike logjistikën e qarkullimit të materialit shpenzues, mjeteve materiale si dhe të pasurive jo financiare në pajtim me rregullat në fuqi;
- Zbaton metodat dhe praktikat më të mira për realizimin e kërkesave logjistike;
- Kujdeset për furnizim me material për zyrë dhe me material tjetër shpenzues në mënyrë efikase sipas kërkesave që vijnë nga njësitë tjera organizative të BQK-së;
- Në mungesë të personelit për logjistikë realizon kërkesat të cilat vijnë nga stafi i BQK-së për furnizim me material përkatës nga depoja;
- Mirëmban dokumentacionin lidhur me logjistikën duke regjistruar çdo kërkesë me qëllim të raportimit të shpenzimeve periodike;
- Kujdeset për regjistrimin e hyrjeve-daljeve të materialit në kuadër të deposë dhe i raporton në mënyrë të rregullt javore dhe mujore Udhëheqësit të Divizionit;
- Kujdeset për furnizimin e deposë me material të nevojshëm dhe bënë mirëmbajtjen e deposë në aspektin material dhe administrativ;
- Bashkëpunon dhe asiston zyrtarin administrativ për regjistrimin dhe monitorimin e pasurive jo financiare të BQK-së;
- Bashkëpunon ngushtë me personelin për logjistikë për planifikimin dhe realizimin e kërkesave të rregullta;
- Kryen punë tjera të ngjashme me kërkesë dhe sipas udhëzimeve të Udhëheqësit të Divizionit.

**Kualifikimet e kërkuara:**

- Diplomë universitare;
- Përvojë pune së paku 3 vite;
- Njohuri të mira të praktikave dhe standardeve për logjistikë që lidhen me natyrën e punës;
- Rrjedhshmëri në të folur dhe në të shkruar të gjuhës shqipe dhe/ose serbe;
- Njohja e gjuhëve të huaja (anglisht) e dëshirueshme;
- Aftësi të mira komunikuese dhe te jetë i gatshëm për punë ne grup;
- Aftësi të mira të teknologjisë, programet Microsoft (Word, Excel, Outlook) Internet, etj.

**Të gjithë kandidatët duhet t'i dërgojnë dokumentet e nevojshme:**

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga organizata kompetente;
- Kopjet e diplomave, diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura/ nostrifikuara zyrtarisht nga MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

**Procedura e aplikimit:**

- Afati i fundit për aplikim është **09 janar 2019**.
- Aplikimi mund të bëhet on line (https://hris.bqk-kos.org) ose përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së, nr.22. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare www.bqk-kos.org
- **Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.**

BQK

**BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**
**CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO**
**CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO**

## KONKURS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

**Naziv radnog mesta :** **Mladi zvaničnik logistike**

**Odeljenje:** **Odeljenje za administrativne usluge i transport**

**Stepen radnog mesta:** 7

**Izveštava:** **Šefu Odeljenja**

**Pregled dužnosti i odgovornosti:**

- Planira, sprovodi i efikasno i ekonomično kontroliše logistiku cirkulacije potrošnog materijala, materijalnih sredstava i nefinansijske imovine u skladu sa važećim pravilima;
- Sprovodi najbolje metode i prakse za realizaciju logističnih zahteva;
- Stara za snabdevanje kancelarijskog materijala i drugog potrošnog materijala na efikasan način prema zahtevima koji dolaze od drugih organizacionih jedinica CBK;
- U nedostatku logističkog osoblja ispunjava zahteve koji dolaze iz osoblja CBK-a za snabdevanje relevantnim materijalom iz skladišta;
- Održava logističku dokumentaciju tako što registruje svaki zahtev u cilju izveštavanja periodičnih troškova;
- Stara se o registraciji ulaza-izlaza materijala u skladište i izveštava na redovnoj sedmičnoj i mesečnoj osnovi šefu odeljenja;
- Stara se za snabdevanje skladišta potrebnim materijalom i održava skladište u materijalnom i administrativnom pogledu;
- Sarađuje i pomaže administrativnom službeniku u registraciji i nadzoru nefinansijske imovine CBK;
- Blisko sarađuje sa osobljem logistike u planiranju i realizaciji redovnih zahteva;
- Obavlja druge poslove slične zahtevu i prema uputstvima šefa Odeljenja.

**Potrebne kvalifikacije:**

- Univerzitetska diploma;
- Radno iskustvo od najmanje 3 godine;
- Dobro poznavanje logističkih praksi i standarda vezanih za prirodu posla;
- Dobro poznavanje pisanog i verbalnog albanskog i/ili srpskog jezika;
- Poznavanje stranih jezika (engleskog) je poželjno;
- Dobre komunikacijske veštine i spremnost za grupni rad;
- Dobro poznavanje informacione tehnologije, Microsoft (Word, Excel, Outlook) programa, Interneta, itd.

**Svi kandidati treba da podnesu sledeće dokumente:**

- Zvanični obrazac CBK-a za apliciranje;
- Prateće pismo u kojem naglašava interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu koju izdaje nadležna organizacija;
- Kopije diploma, diplome koje su stečene van Republike Kosovo treba da budu zvanično priznate/ potvrđene od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu i stalnom mestu boravka na Kosovu.

**Procedura apliciranja:**

- Rok za apliciranje je **09. januar 2019**. **godine**;
- Apliciranje se može vršiti putem interneta (https://hris.bqk-kos.org) ili putem zvaničnog veb-sajta CBK ili preko CBK arhive, br. 22. Nijedan drugi oblik apliciranja neće biti uzet u obzir;
- Obrazac za apliciranje možete preuzeti na zvaničnom veb-sajtu: www .bqk-kos.org ;
- **Nepotpuna dokumentacija neće biti razmatrana.**


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola
0.5L


AUTOSHKOLLA
"RITMO – L"
Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë
Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.
Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333